



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 46**

**4 prill**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 102/2013 datë 25.3.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Korçë (KRWM) dhe KFW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”	2041
Ligj nr. 103/2013 datë 25.3.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit.....	2066
Ligj nr. 104/2013 datë 25.3.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP).....	2072

**LIGJ**  
**Nr. 102/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCEVE, E SHOQATËS RAJONALE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA  
NË KORÇË (KRWM) DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT  
“MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Korçë (KRWM) dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8073, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE HUAJE, FINANCIMI DHE PROJEKTI** datë .....

**NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW)**  
**DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE**  
**(HUAMARRËSI/MARRËSI) DHE KRWM, SHOQATA RAJONALE E KORÇËS**  
**PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT)**  
**PËR 3,400,000.00 EURO (HUAJA) DHE 5,400,000.00 EURO (GRANTI)**

- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë (2008 65 170)

Mbi bazën e marrëveshjes së datës 19 korrik 2011, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010 për projektin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë (marrëveshje qeveritare), huamarrësi/marrësi, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të huas, financimit dhe projektit.

**Neni 1**

**Shuma dhe qëllimi i huas**

1.1 KfW-ja i jep huamarrësit/marrësit një hua që nuk i kalon 3,400,000.00 euro dhe një kontribut financiar që nuk i kalon 5,400,000.00. euro.

Kontributi financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 5.3.



1.2 Huamarrësi/marrësi e kanalizon huan dhe kontributin financiar plotësisht në agjencinë e zbatimit të programit, në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit e përdor huan dhe kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e ndërtimit të një vendgrumbullimi mbeturinash sanitare, vendet e transferimit dhe mjediset për selinë e KRWM-së, të fazës së dytë të zbatimit të projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë”, si dhe për blerjen e pajisjeve të nevojshme të lëvizshme për operimin e vendgrumbullimit të mbeturinave, për transportin nga vendet e transferimit në gropën e mbetjeve, si dhe për pajisjet e mbledhjes dhe transportit për shërbimet bashkiake të mbledhjes së mbetjeve (projekti), dhe kryesisht për të paguar koston e shkëmbimit të huaj. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e projektit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë, e cila duhet të bihet dakord me huamarrësin/marrësin dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

1.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që lindin nga huamarrësi/marrësi ose agjencia e zbatimit të projektit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga huaja apo kontributi financiar.

#### Neni 2

### **Kanalizimi i huas dhe kontributit financiar tek agjencia e zbatimit të projektit**

2.1 Huamarrësi/marrësi e kanalizon huan dhe kontributin financiar tek agjencia e zbatimit të projektit si një grant i pashlyeshëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga huaja dhe kontributi financiar, huamarrësi/marrësi i dërgon KfW-së një kopje dhe përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huas dhe i kontributit financiar nuk përbën detyrim të agjencisë së zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 3

### **Disbursimi**

3.1 KfW-ja e disburson huan dhe kontributin financiar në pajtim me progresin e projektit dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Nëpërmjet marrëveshjes së veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja bien dakord për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat e vërtetimit që shumat e kërkuara të huas dhe fondet e disbursuara nga kontributi financiar janë përdorur për qëllimin e parashikuar. Marrëveshja e veçantë duhet të miratohet nga huamarrësi/marrësi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3.2 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të bërjes së disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2016.

#### Neni 4

### **Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja e huas**

4.1 Huamarrësi/marrësi paguan një tarifë angazhimi prej 1/4% në vit për shumat e padisbursuara të huas. Tarifa e angazhimit llogaritet për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe që përfundon në datën në të cilën debitohej disbursimet.

4.2 Huamarrësi/marrësi paguan interes për huan me normën prej 0.75% në vit. Interesi aplikohet nga datat në të cilat debitohej disbursimet deri në datat në të cilën kreditohen shlyerjet në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi/marrësi paguan tarifën e angazhimit, interesin dhe çdo interes për prapambetjet në pajtim me nenin 4.5, në çdo gjashtë muaj, më 30 qershor dhe më 30 dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron në atë datë. Tarifa e parë e angazhimit bëhet e kërkueshme së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi/marrësi e shlyen huan si më poshtë:

Kësti	Datë		Shuma	
1	30 qershor	2023	56.000,00	euro
2	30 dhjetor	2023	56.000,00	euro
3	30 qershor	2024	56.000,00	euro
4	30 dhjetor	2024	56.000,00	euro

5	30 qershor	2025	56.000,00	euro
6	30 dhjetor	2025	56.000,00	euro
7	30 qershor	2026	56.000,00	euro
8	30 dhjetor	2026	56.000,00	euro
9	30 qershor	2027	56.000,00	euro
10	30 dhjetor	2027	56.000,00	euro
11	30 qershor	2028	56.000,00	euro
12	30 dhjetor	2028	56.000,00	euro
13	30 qershor	2029	56.000,00	euro
14	30 dhjetor	2029	56.000,00	euro
15	30 qershor	2030	56.000,00	euro
16	30 dhjetor	2030	56.000,00	euro
17	30 qershor	2031	56.000,00	euro
18	30 dhjetor	2031	56.000,00	euro
19	30 qershor	2032	56.000,00	euro
20	30 dhjetor	2032	56.000,00	euro
21	30 qershor	2033	57.000,00	euro
22	30 dhjetor	2033	57.000,00	euro
23	30 qershor	2034	57.000,00	euro
24	30 dhjetor	2034	57.000,00	euro
25	30 qershor	2035	57.000,00	euro
26	30 dhjetor	2035	57.000,00	euro
27	30 qershor	2036	57.000,00	euro
28	30 dhjetor	2036	57.000,00	euro
29	30 qershor	2037	57.000,00	euro
30	30 dhjetor	2037	57.000,00	euro
31	30 qershor	2038	57.000,00	euro
32	30 dhjetor	2038	57.000,00	euro
33	30 qershor	2039	57.000,00	euro
34	30 dhjetor	2039	57.000,00	euro
35	30 qershor	2040	57.000,00	euro
36	30 dhjetor	2040	57.000,00	euro
37	30 qershor	2041	57.000,00	euro
38	30 dhjetor	2041	57.000,00	euro
39	30 qershor	2042	57.000,00	euro
40	30 dhjetor	2042	57.000,00	euro
41	30 qershor	2043	57.000,00	euro
42	30 dhjetor	2043	57.000,00	euro
43	30 qershor	2044	57.000,00	euro
44	30 dhjetor	2044	57.000,00	euro
45	30 qershor	2045	57.000,00	euro
46	30 dhjetor	2045	57.000,00	euro
47	30 qershor	2046	57.000,00	euro
48	30 dhjetor	2046	57.000,00	euro
49	30 qershor	2047	57.000,00	euro
50	30 dhjetor	2047	57.000,00	euro
51	30 qershor	2048	57.000,00	euro
52	30 dhjetor	2048	57.000,00	euro
53	30 qershor	2049	57.000,00	euro
54	30 dhjetor	2049	57.000,00	euro
55	30 qershor	2050	57.000,00	euro
56	30 dhjetor	2050	57.000,00	euro
57	30 qershor	2051	57.000,00	euro
58	30 dhjetor	2051	57.000,00	euro
59	30 qershor	2052	57.000,00	euro
60	30 dhjetor	2052	57.000,00	euro



4.5 Nëse një këst shlyerjeje nuk është në zotërim të KfW-së kur bëhet i kërkueshëm, KfW-ja mund të rrisë normën e interesit për vonesat mbi normën bazë plus 3% në vit për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën kreditohen këto shlyerje në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9. “Norma bazë” është norma e interesit e deklaruar nga Deutsche Bundesbank, si normë bazë në normën e zbatueshme për datën përkatëse të kërkueshme. Në rastin e vonesave në interesa, KfW-ja mund të pretendojë zhdëmtim. Ky zhdëmtim nuk e kalon shumën që përftohet nëse do të ishte vendosur interes mbi këto vonesa interesi me normën bazë që zbatohet në datën e kërkueshme plus 3% në vit.

4.6 Tarifa e angazhimit, interesi dhe çdo detyrim mbi vonesat në pajtim me nenin 4.5 llogariten mbi bazën e vitit me 360 ditë dhe muaj me 30 ditë.

4.7 Shumat e padisbursuara ose të shlyera para kohe të huas kreditohen në pjesë të barabarta në të gjitha këstet e shlyerjeve të pakryera, përveç kur KfW-ja, në diskrecionin e saj, përcakton një mënyrë të ndryshme kompensimi në një rast konkret, veçanërisht në rastin e shumave me një volum të vogël.

4.8 KfW-ja ka të drejtën të kreditojë, në diskrecionin e saj, pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme, sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas, të lidhura ndërmjet KfW-së dhe huamarrësit/marrësit.

4.9 Huamarrësi/marrësi i dërgon të gjitha pagesat në euro në llogarinë nr. 31.02560801 te KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S.W.I.F.T.: KFWIDEFF), duke mos u lejuar asnjë e drejtë kompensimi kundrejt kundërpretendimeve.

## Neni 5

### **Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja e parakohshme**

5.1 Huamarrësi/marrësi, në çdo kohë, mund:

a) të anulojë ndonjë shumë huaje që nuk është disbursuar, duke përmbushur kushtet e nenit 8; dhe

b) të shlyejë huan plotësisht ose pjesërisht para afatit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet e huas ose të kontributit financiar, përveç kur:

a) huamarrësi/marrësi nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj marrëveshjeje janë shkelur;

c) agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huas ose të kontributit financiar janë përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

d) kanë dalë rrethana të jashtëzakonshme të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesave të marra përsipër nga huamarrësi/marrësi sipas kësaj marrëveshjeje.

5.3 Nëse një nga situatat e përcaktuara në nenin 5.2 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

a) të kërkojë, në rastet e specifikuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b), shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të pashlyera të huas, si dhe shlyerjen e të gjithë interesit të mbledhur dhe të gjitha shpenzimet e tjera rastësore; dhe në rastin e specifikuar në nenin 5.2 b), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara të kontributit financiar;

b) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave të huas që agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar; dhe

c) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave të kontributit financiar që agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 6

**Kostoja dhe detyrimet publike**

6.1 Huamarrësi/marrësi i bën të gjitha pagesat që duhet të kryhen sipas kësaj marrëveshjeje pa ndonjë zbritje për taksa, detyrime të tjera publike apo shpenzime të tjera, dhe paguan koston e transferimit dhe konvertimit që kërkohet në lidhje me disbursimin e huas.

6.2 Huamarrësi/marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mblidhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 7

**Vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje dhe përfaqësimi**

7.1 Në momentin e duhur para disbursimit të parë, huamarrësi/marrësi i jep KfW-së prova të pranueshme për KfW-në që huamarrësi/marrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat, sipas ligjit të tij kushtetues dhe ligje të tjera për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje.

7.2 Ministri i Financave dhe ata persona të caktuar prej tij ose asaj ndaj KfW-së dhe të autorizuar me modele nënshkrimesh të certifikuara prej tij ose saj përfaqësojnë huamarrësin/marrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Administratori i përgjithshëm i KRWM-së dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj ndaj KfW-së dhe të autorizuar me modele nënshkrimesh të certifikuara prej tij ose saj përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Prokura nuk skadon derisa revokimi nga përfaqësuesi i autorizuar për atë kohë të merret nga KfW-ja.

7.3 Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaram i tillë quhet i marrë nëse mbërrin në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese që i njoftohet palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:	KfW LE a/4 Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Federal Republic of Germany Faks: +49 69 7431-2944
Për huamarrësin/marrësin:	Ministria e Financave Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1 Tiranë Republika e Shqipërisë Faks: +355 42 22 8494
Për agjencinë e zbatimit të projektit:	KRWM Rr. “Konferenca e Pezës” Ish-shkolla “Th. Kavalioti”, kati II, Korçë Republika e Shqipërisë Tel./faks: +355 822 481 86

7.4 Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, që ndikojnë vetëm në marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe huamarrësit/marrësit, nuk kërkojnë pëlqimin e agjencisë së zbatimit të projektit.



## Neni 8 Projekti

### 8.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe e mban projektin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e projektit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) u ngarkon përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit konsulentëve të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) u jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar me ofertë konkurruese ndërkombëtare paraprake;

d) mban ose merr masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo hua dhe ky kontribut financiar;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë inspektimin e këtyre librave dhe regjistrave dhe çdo dokumentacioni tjetër të përshtatshëm për zbatimin e projektit, dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

f) t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet mbi projektin dhe përparimin e tij të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja.

g) pa vonesë, i kalon KfW-së çdo pyetje që merret nga huamarrësi/përftuesi nga OECD-ja ose anëtarët e saj, sipas të ashtuquajturës “Marrëveshje për Untied ODA Credits Transparency”, pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe bashkërendon përgjigjen për çdo kërkesë të tillë me KfW-në.

8.2 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 8.1 në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga huamarrësi/marrësi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

### 8.3 Huamarrësi/marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) sigurojnë financim të plotë të projektit dhe, me kërkesë, i japin prova KfW-së që provon që kostoja e cila nuk paguhet nga kjo hua dhe kontribut financiar do të mbulohet; dhe

b) me iniciativë të tyre njoftojnë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi/marrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, asiston agjencinë e zbatimit të projektit, në pajtim me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e programit dhe në përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit, sipas kësaj marrëveshjeje dhe veçanërisht, i japin agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar, zbatohen dispozitat e marrëveshjes qeveritare, të cilat janë të njohura për huamarrësin/marrësin.

## Neni 9 Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi/marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e çdo kontrate për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të huas të mos kërkojnë, prezumojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose përftojnë një premtim për pagesa të paligjshme dhe avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Agjencia e zbatimit të projektit i ofron KfW-së menjëherë me kërkesë të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me agjencinë e zbatimit të projektit, që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, agjencia e zbatimit të projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të agjencisë së zbatimit të projektit:

a) burimet e veta të agjencisë së zbatimit të projektit ose shumat e investuara në financimin e projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) kapitali i aksionerëve të agjencisë së zbatimit të projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) agjencia e zbatimit të projektit nuk do të përfshihet në përfitim, zotërimin ose përdorimin e pasurisë që është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin; dhe

d) agjencia e zbatimit të projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit.

9.3 KfW-ja ka të drejtë t'i japë Republikës Federale Gjermane çdo informacion në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje. KfW-ja dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtat për t'u dhënë informacion në lidhje me huan, kontributin financiar dhe projektin, duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar, organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me aspekte të shërbimit të borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në lidhje me dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja. E drejta e mësipërme për t'u dhënë informacion organizatave ndërkombëtare përfshin, gjithashtu, të drejtën për t'u dhënë këtë informacion anëtarëve të këtyre organizatave.

9.4 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh prej tij plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

9.5 Huamarrësi/marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të cedojë, të transferojë, të lërë peng ose të rëndojë me hipotekë asnjë pretendim të kësaj marrëveshjeje.

9.6 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh nga përfundimi i vitit në të cilin ka lindur një pretendim i tillë dhe në të cilin KfW-ja është vënë në dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë të drejtë ose që mund të ishte vënë në dijeni të tij pa neglizhencë të rëndë.

9.7 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurt am Main.

9.8 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohet sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra të cilët emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh zhvillohet në Frankfurt am Main. Gjykimi zhvillohet në gjuhën angleze.

9.9 Kjo marrëveshje huaje, financimi dhe projekti nuk hyn në fuqi nëse huamarrësi/marrësi nuk informon KfW-në me shkrim që marrëveshja e huas, financimit dhe projektit është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar rregullisht.

Bërë në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më 2012,

Tiranë, më 2012

KfW

Republika e Shqipërisë  
përfaqësuar nga:  
Ministria e Financave  
përfaqësuar nga:

Korçë, më 2012  
KRWM





përfaqësuar nga:

Shoqata Rajonale e Korçës për Menaxhimin e  
Mbetjeve (KRWM)  
Rr. “Konferenca e Pezës”  
Ish-shkolla “Th. Kavalioti”, kati II  
Korçë

Adelheid Knwble de Revollo  
ref. jonë.: Knä  
tel.: +49 69 7431-4448  
email: Adelheid.Knaeble\_de\_Revollo@kfw.de  
Datë 2.11.2012

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit  
Sheshi Skënderbej, NR.S  
Tiranë

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Tiranë  
Republika e Shqipërisë

LE a/4 Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë  
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë

8.8 milionë euro (huaja dhe kontributi financiar) për investime  
Nr.: 2008 65 170

1.0 milionë euro për masat shoqëruese  
Nr.: 2010 65 176

Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas, financimit dhe projektit, datë  
xx.xx.xxxx dhe marrëveshjen e financimit, datë xx.xx.xxxx

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në pajtim me marrëveshjen e huas, financimit dhe projektit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi), KRWM (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-së (KfW), të datës xx.xx.xxxx dhe marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (“marrësi”, këtu i quajtur “huamarrësi”), KRWM-së (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-së (KfW) të datës xx.xx.xxxx, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2:

Hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar.

Në pajtim me nenin 3.1 të marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe në pajtim me nenin 3.1 të marrëveshjes së financimit.

Procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë që shumat e disbursuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar.

Në pajtim me nenin 8.2 të marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe në pajtim me nenin 7.3 të marrëveshjes së financimit.

Hollësitë në lidhje me nenin 8.1 (zbatimi i projektit) të marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe hollësitë në lidhje me nenin 7.1 (zbatimi i projektit) të marrëveshjes së financimit.

Ne propozojmë të miratohet sa më poshtë:

I. Hartimi i projektit

1. Hollësitë e programit

Projekti mbulon fazën e dytë të zbatimit të projektit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë. Qëllimi i të gjithë projektit është zbatimi i një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Korçës, që mbron burimet natyrore dhe mjedisin, si dhe shëndetin e

njeriut. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit publik, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe shmangien e ndotjes mjedisore. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit, si dhe faktorët që mbështesin qëllimin e projektit dhe rezultatet e projektit gjenden në aneksin 1.

Hartimi i projektit bazohet në dokumentet e studimit të fizibilitetit dhe fazës ndërlidhëse që i janë vënë në dispozicion KfW-së, huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit dhe bashkive të Pogradecit, Korçës dhe Maliqit gjatë vlerësimit të projektit lokal (protokolli i mbledhjes së datës 16 shtator 2009), në marrëveshjet e lidhura ndërmjet KfW-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (letër e sigluar e datës 2 dhjetor 2009), dhe në protokollin e mbledhjes së datës 17 dhjetor 2010 të nënshkruar nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja. Për më tepër, hartimi i projektit bazohet në dokumentet dhe rezultatet e fazës së parë të zbatimit që i ofrohet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së që janë miratuar në marrëveshjen e financimit dhe projektit që janë lidhur ndërmjet huamarrësit, agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së më 23 dhjetor 2010.

Aktivitetet pasuese të projektit të fazës së dytë të zbatimit të projektit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë financohen nga huaja dhe kontributi financiar:

- ndërtimi i një vendgrumbullimi të ri mbetjesh sanitare në Maliq;
- përmirësimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve inerte urbane;
- ndërtimi i stacioneve të transferimit dhe sigurimi i pajisjeve të transferimit të mbetjeve inerte urbane;
- përmirësimi i aktiviteteve të riciklimit, kompostimit dhe mbetjeve të rrezikshme;
- përmirësimi i operimit të sektorit KRWM-së;
- masat e paparashikuara.

Mbyllja e gropave të vjetra të mbetjeve të financuara nga kontributet lokale mbështetet edhe në fazën e dytë të zbatimit. Investimet e nevojshme të parashikuara për këto masa përmbledhen në përmbledhjen e përgjithshme në aneksin 2. Konsulenti i zbatimit i financuar nga fondet e grantit të siguruara për fazën e parë të zbatimit, mbështet KRWM-në në përgatitjen dhe zbatimin e këtyre masave të investimeve.

Kontributi financiar përdoret për masat shoqëruese për të mbështetur PEA-në gjatë fazës së dytë të zbatimit për të përmirësuar strukturën e tyre institucionale dhe financiare dhe të ofrojë masat e ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimin për operimin e ardhshëm.

## 2. Grafiku kohor

Grafiku kohor përkatës për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e projektit gjendet në aneksin 3.

## 3. Kostoja dhe financimi i plotë

Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit (kosto e plotë) e mbështetur në vlerësimin e projektit është afërsisht 10.5 milionë euro për fazën e dytë të zbatimit. Shuma e huas është 3.4 milionë euro dhe përdoret kryesisht për ndërtimin e një grope të re mbetjesh sanitare dhe ndërtimin e vendeve të transferimit. Nëse ka një shumë të mbetur nga huaja që nuk nevojitet për këto ndërtime, shumën e huas mund të përdoret, gjithashtu, për artikuj të tjerë të investimeve që përmenden në aneksin 4. Në rastin e mbetjeve të mëtejshme të shumave të huas, Ministria e Financave dhe KfW-ja bien dakord për përdorimin e këtyre fondeve. Kontributi financiar është 5.4 milionë euro. Kontributi lokal është 0.7 milionë euro. Kontributi financiar për masat shoqëruese është 1.0 milion euro. Përbërja e koston së plotë dhe plani financiar gjenden në aneksin 4.

## 4. Ndryshimet në hartimin e projektit

Çdo ndryshim i rëndësishëm në hartimin e projektit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Agjencia e zbatimit të projektit njofton për këtë KfW-në menjëherë, duke përcaktuar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë koston e plotë). Zbatimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

## II. Zbatimi i projektit

### 1. Përgjegjësitë dhe grafiku kohor, i koston dhe financimit

#### 1.1 KRWM-ja është përgjegjëse për zbatimin dhe operimin e projektit.



1.2 Grafiku i detajuar i kohës, kostos dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të projektit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga agjencia e zbatimit të projektit në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen kronologjike të aktiviteteve të projektit dhe kërkesat përkatëse financiare. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

#### 2. Caktimi i konsulentit

2.1 Konsulenti i masës shoqëruese zhvillon, planifikon dhe kryhen masat këshillimore që synojnë mbështetjen e PEA-s gjatë fazës së dytë të zbatimit dhe mbështetjen e strukturës së tyre financiare dhe menaxhimit financiar. Ai ofron më tej masa për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimi për detyrat përkatëse. (Detyrat e konsulentit të zbatimit për fazën e dytë të zbatimit janë parashikuar në marrëveshjen e veçantë të marrëveshjes financiare “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindjen e Shqipërisë” të datës 23 dhjetor 2010.)

2.2 Pas parakualifikimit dhe tenderimit ndërkombëtar konkurrues publik, kontrata i jepet një konsulentit të pavarur. Procedura për dhënien e kontratës rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 5), që përbën pjesë integrale të kësaj.

2.3 Në njoftimin e parakualifikimit, si dhe në ftesën për tender, agjencia e zbatimit të projektit detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me shprehjen e interesit dhe së bashku me ofertën një deklaratë angazhimi të nënshkruar rregullisht (aneksi 5, faqe 16).

2.4 PEA i kërkon KfW-së moskundërshtimin e dokumenteve të mëposhtme:

- dokumentet e parakualifikimit;
- raportin e vlerësimit të parakualifikimit;
- dokumentet e tenderit për kërkesën për propozim;
- raportin e vlerësimit teknik;
- raportin e përgjithshëm të vlerësimit të tenderit me rekomandimin për dhënien e kontratës;
- projektkontratat e konsulentit.

#### 3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për ndërtimet, mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera përgatiten dhe jepen në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender.

3.3 Afati i ofertimit përcaktohet në mënyrë të tillë që t'u mundësojë ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e tjera në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen tek “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe sipërmarrjes sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 6), që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit, si dhe në dokumentet e tenderit, agjencia e zbatimit të projektit detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me shprehjen e interesit dhe së bashku me ofertën një deklaratë angazhimi (aneksi 6, faqe 27).

3.6 Përveç sa më sipër, PEA i kërkon KfW-së moskundërshtimin për dokumentet e mëposhtme:

- dokumentet e parakualifikimit;
- raportin e vlerësimit të parakualifikimit;
- raporti i vlerësimit teknik të ofertave;
- raportin e përgjithshëm të vlerësimit të tenderit me rekomandimin për dhënien e kontratës.

3.7 Gjatë lidhjes së kontratave për ndërtimet, mallrat dhe shërbime të tjera që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar, agjencia e zbatimit të projektit duhet të respektojë edhe parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse tarifat e importit nuk mund të financohen nga huaja dhe kontributi financiar në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe nenin 1.4 të marrëveshjes së financimit, këto tarifa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, përcaktohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave të mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhen nga huaja dhe kontributi financiar, këto kontrata duhet të përfshijnë një dispozitë që parashikon që të gjitha rimbursimet, garancitë ose pagesat e ngjashme të pretendueshme dhe çdo pagesë sigurimesh të bëhen për llogari të agjencisë së zbatimit të projektit në llogarinë nr 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) te KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën vendase, ato dërgohen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të projektit në vendin e agjencisë së zbatimit të projektit, të cilat mund të tërhiqen vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.8 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet KfW-së, i jepet për koment projektkontrata, siç është rënë dakord, të certifikuar rregullisht nga konsulentët. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje pasuese ndryshuese ose modifikuese.

#### 4. Marrëveshje të veçanta të zbatimit

4.1 Para publikimit të tenderit për ndërtimin e vendgrumbullimit sanitar në fazën e zbatimit 2, merret leja e ndërtimit për gropën e re në Maliq.

4.2 Para kontraktimit të shërbimeve për ndërtimin dhe para disbursimit të parë të fondeve të parashikuara në fazën 2 të zbatimit, duhet të përfundohet procesi i shpronësimit të tokës.

#### 5. Dispozita për operimin e rregullt të projektit

Për të garantuar operimin e duhur të projektit, agjencia e zbatimit të projektit përshtat strukturën organizative siç është përgatitur gjatë zbatimit të projektit nga konsulentët e masave shoqëruese dhe rekruton personel sipas parashikimit në të, para dhënies së punëve të ndërtimit për vendgrumbullimin sanitar në Maliq. Gjithashtu, agjencia e zbatimit të projektit i paraqet KfW-së një parashikim financiar për të gjitha shërbimet që ofron. Parashikimi i përpiluar, në bashkëpunim me konsulentin e masave shoqëruese, aprovohet nga bordi mbikëqyrës, para kryerjes së punëve të ndërtimit. Parashikimi tregon shpenzimet e shkaktuara nga projekti dhe të ardhurat e gjeneruara, veçanërisht nga tarifat e portave që priten për shërbimet e dhëna në kohën që kryhen. Agjencia e zbatimit të projektit përditëson periodikisht këtë parashikim dhe siguron që boshllëqet financiare të mbulohen në kohën e duhur. Agjencia e zbatimit të projektit ia paraqet pa vonesë KfW-së këtë parashikim financiar dhe versionet e tij të rishikuara.

#### III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

##### 1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar përgatitet mbi bazën e kontratave të përfunduara për këto mallra dhe shërbime. Po ashtu, KfW-së i jepet një origjinal ose kopje e çdo kontrate të tillë dhe të çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse një masë projekti duhet të zbatohet bazuar në fuqinë punëtore dhe nuk janë lidhur kontrata, KfW-së i jepet, në mungesë të kontratës, një grafik i masave të planifikuara, të detajuara në kategoritë kryesore të kostos (grafiku i masave të fuqisë punëtore). Kostoja e shkaktuar për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punën, sipas fuqisë punëtore nuk duhet të përfshihen në këtë grafik të masave të llogarisë së fuqisë punëtore.

1.3 KfW-ja njofton agjencinë e zbatimit të projektit, me kërkesë, për shumat e huas dhe të kontributit financiar që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

##### 2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret e parashikuara në aneksin nr. 7 (procedura e disbursimit), që formon pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

#### IV. Dispozita për raportimin dhe të tjera

##### 1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të dytë, agjencia e zbatimit të projektit i raporton në çdo tremujor KfW-së mbi progresin e projektit (raporte progresi), duke përfshirë përmbushjen e marrëveshjeve të veçanta të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 8. Përveç kësaj, agjencia e zbatimit të projektit raporton mbi të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimit të projektit dhe rezultateve. Në momentin e përfundimit fizik dhe vënies në funksionim të projektit, por jo më vonë se para mbarimit të afatit të garancisë, agjencia e zbatimit të projektit paraqet



një raport përfundimtar për masat e zbatuara. Raporti i parë mbi situatën e punëve duhet të paraqitet tre muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje të veçantë. Raportet duhet të merren nga KfW-ja jo më vonë se 2 javë pas përfundimit të periudhës nën rishikim. Raportet siglohen nga konsulenti për afatin e caktimit të konsulentit.

1.2 Nëse agjencia e zbatimit të projektit ka ngarkuar konsulentin të hartojë raporte progresi dhe/ose raportin përfundimtar, agjencia e zbatimit të projektit komenton mbi raportet ose bën të ditur aprovimin e përmbytjes duke sigluar raportet.

1.3 Përveç kësaj, agjencia e zbatimit të projektit paraqet raporte të shkurtra për situatën (maksimalisht 2-3 faqe), duke përfshirë një përshkrim të shkurtër të progresit të projektit duke vënë në dukje pengesat dhe sfidat, si dhe veprimin përkatës korrigjues të marrë.

1.4 Pas përfundimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit raporton mbi zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 8 për hollësi). KfW-ja informon KfW-në në kohën e duhur në lidhje me përfundimin e afatit të raportimit.

## 2. Dispozita të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të projektit i dërgon KfW-së të gjitha ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në për të bërë komente dhe për të dhënë aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëngjitura në kohën e duhur për të dhënë kohë të mjaftueshme për shqyrtim.

2.2 Agjencia e zbatimit të projektit vendos të gjitha pllakatat e projektit, të cilat përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Republikës së Shqipërisë, i zbatuar nga KRWM-ja, i bashkëfinancuar nga Republika Federale Gjermane nëpërmjet KfW-së.”

Një vulë projekti e dhënë nga Ambasada Gjermane vendoset në pllakatën e projektit.

2.3 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me pëlqim të përbashkët, nëse kjo çmohet e dobishme për zbatimin e projektit ose zbatimin e marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe marrëveshjes së financimit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e neneve 7.3 dhe 9 të marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit dhe neneve 6.2 dhe 8 të marrëveshjes së financimit zbatohen përkatësisht për këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme, duke nënshkruar në një formë ligjrisht detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Jeni të lutur t'u kaloni konsulentëve një kopje të kësaj letre në kohën e duhur.

Me respekt,  
KfW

## ANEKSE

Aneksi 1. Objektivat dhe rezultatet e projektit dhe faktorët për arritjen e tyre

Aneksi 2. Përmbledhje e përgjithshme e investimit

Aneksi 3. Grafiku kohor

Aneksi 4. Kostoja totale dhe financimi

Aneksi 5. Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim (FI050)

Aneksi 6. Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim (FI051)

Aneksi 7. Procedura e disbursimit

Aneksi 8. Përmbytja dhe forma e raportimit, duke përfshirë tabelën e monitorimit

Lexuar dhe rënë dakord:

Ministria e Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

KRWM

## ANEKSI 1 KUADËR-MENAXHIMI I MBETJEVE NË JUGLINDJE TË SHQIPËRISË

Objektivi i përgjithshëm

Kontribuimi për përmirësimin e shëndetit publik, mbrojtja e burimeve natyrore dhe shmangia e ndotjes mjedisore.

Faktorët për arritjen e objektivit të përgjithshëm

Fushatat e ndërgjegjësimit kontribuojnë për sensibilizimin e popullatës për mbrojtjen e mjedisit.

Financim i mjaftueshëm do të jepet nga bashkitë për të qenë mbrojtëse nga pikëpamja mjedisore pranë vendeve ekzistuese të mbetjeve.

Objektivi i projektit

Zbatimi i një sistemi të qëndrueshëm menaxhimi të mbetjeve në rajonin e Korçës që mbron burimet natyrore, mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Treguesit për arritjen e objektivit të projektit

Bashkitë dhe komunat që janë pjesë e KRWM-së përfaqësojnë të paktën 70% të popullatës së rajonit.

Norma e mbledhjes së mbeturinave në zona urbane është të paktën 90% e mbetjeve totale.

Norma e mbledhjes së mbeturinave në zona rurale është të paktën 70% e mbetjeve totale.

Vendosje e rregullt i 100% të mbeturinave të pariciklueshme në vendgrumbullim.

Mbulim i kostos operative nëpërmjet tarifave në masën 80%.

Faktorët për arritjen e objektivit të projektit

Bashkitë dhe komunat vazhdojnë të bashkëpunojnë me KRWM-në.

KRWM-ja realizon punësimin e personelit të kualifikuar.

Rritja e tarifave është politikisht i pranueshëm.

Rezultati 1

Gropa mbeturinash të mjaftueshme dhe kapacitete logjistike për të siguruar hedhjen e mbeturinave, duke ruajtur mjedisin:

- ndërtimi i një grope të re në Maliq;
- ndërtimi i vendeve të transferimit;
- dorëzimi i kontejnerëve dhe kamionëve të përshtatshëm;
- dhënia e pajisjeve të lëvizshme për gropat e plehrave.

Rezultati 2

Bashkitë dhe komunat kanë përmirësuar mbledhjen e mbeturinave dhe transportin e tyre:

- dhënia e kamionëve të mbledhjes;
- prokurimi i kontejnerëve.

Rezultati 3

Shoqata e Menaxhimit të Mbetjeve është e trajnuar rregullisht dhe e pajisur për të përmbushur detyrat e saj:

- masat shoqëruese.

Rezultati 4

Gropat ekzistuese të mbeturinave mbyllen rregullisht.

Shërbimet e ndërtimit në vendet ekzistuese.

Masat që kërkohen për më shumë se një rezultat.

Shërbimet e konsulencës për zbatimin.

Faktorët për arritjen e rezultateve:

- merren lejet mjedisore dhe të ndërtimit;
- grupa e mbeturinave mbetet e pakundërshtueshme.



ANEKSI 2  
PËRMBLEDHJE E PËRGGJITHSHME E INVESTIMIT

Faza e dytë e zbatimit 2012 - 2014	Përshkrimi i masave të mundshme	Totali (euro)
Ndërtimi i një grope të re sanitare në Maliq	Ndërtimi i seksionit të parë të disponimit të një grope sanitare në vendin e Maliqit, duke përfshirë infrastrukturën përkatëse (rrugët e hyrjes, lidhjet me ujë rrjetin e ujit, furnizimi me energji dhe linja e telefonit, administrimi dhe ndërtesa e hyrjes, ura e peshimit, pajisjet e lëvizshme.	4 400 000
Përmirësimi i mbledhjes së mbetjeve inerte nga bashkia	Blerje e pajisjeve të tjera (automjetet, kontejnerët etj.) për optimizimin e mbledhjes dhe transportit në bashki dhe komuna, nëse konsiderohet e nevojshme pas prokurimeve brenda fazës së parë të zbatimit.	2 500 000
Përmirësimi i transferimit të mbetjeve inerte nga bashkia	Ndërtimi (duke përfshirë pajisjet) i një numri të arsyeshëm të stacioneve të transferimit për fshatrat e largët për të lehtësuar transportin e mbetjeve për vendet e tyre në gropën e re. Kjo përfshin edhe sigurimin e kamionëve dhe kontejnerëve për transportin në distancë të largët.	1 250 000
Përmirësimi i riciklimit, kompostimit dhe aktiviteteve me mbetjet e rrezikshme	Meqë minimizimi i mbetjeve luan rol të rëndësishëm në legjislacionin shqiptar për SWM-në, është parashikuar një buxhet i kufizuar për zhvillimin dhe instalimin e aktiviteteve të riciklimit dhe kompostimit. Sistemi ekzistues i mbledhjes së mbetjeve të rrezikshme nga ekonomitë shtëpiake i zbatuar nga një projekt i mëparshëm i SIDA-s do të përmirësohet.	400 000
Përmirësimi i operimit të selisë së KRWM-së	Blerje e pajisjeve bazë për selinë e KRWM-së për të përmbytur funksionet e saj (p.sh. pajisje zyre, automjete), nëse vazhdon të konsiderohet e rëndësishme pas prokurimit brenda fazës së parë të zbatimit.	100 000
Masat e paparashikuara	Të ndryshme dhe masa të paparashikuara	850 000
Mbyllja e gropave të vjetra të plehrave	Mbyllja, duke mbuluar dhe vulosur sipërfaqen e gropave të përdorura aktualisht nga fshatrat e vogla dhe të mesëm. Këto aktivitete kanë filluar tashmë me disa masa përmirësimi për përmirësimin e operimit të disponimit të gropave kryesore gjatë fazës së parë të zbatimit. Konsulenti i zbatimit mbështet KRWM-në në përgatitjen e koncepteve dhe hapat (planet e veprimit) për mbylljen e vendeve ekzistuese dhe mbështetjen e KRWM-së në mbikëqyrjen e kryerjes së tyre.	Kontribut lokal
<b>Shuma e investimit, faza e dytë e zbatimit</b>		<b>9 500 000</b>
Masa shoqëruese	Masat fuqizuese institucionale	1 000 000
<b>Shuma, faza e dytë e zbatimit</b>		<b>10 500 000</b>







#### ANEKSI 4

Tabela e kostos dhe financimit - faza e 2-të e zbatimit (2012 - 2015)	Kostoja dhe financimi		
	KfW	KRWM	Totali
<b>1. Investimet</b>			
<b>Vendgrumbullimi i ri</b>	<b>3,850,000</b>	<b>550,000</b>	<b>4,400,000</b>
Ndërtimi i vendgrumbullimit	3,100,000		
Blerje e pajisjeve të lëvizshme	750,000		
Blerje e tokës		550,000	
<b>Mbledhja MSW</b>	<b>2,500,000</b>		<b>2,500,000</b>
Masat për mbledhjen e shtuar	1,900,000		
Masat për transportin e shtuar	600,000		
<b>Transferimi</b>	<b>1,150,000</b>	<b>100,000</b>	<b>1,250,000</b>
Ndërtimi i vendeve të transferimit	550,000		
Blerja e kamionëve dhe kontejnerëve	600,000	100,000	
<b>Riciklimi, kompostimi, mbetjet e rrezikshme</b>	<b>400,000</b>		<b>400,000</b>
Selia e KRWM-së	100,000		100,000
Fond rezervë (rreth 10%)	800,000	50,000	850,000
<b>Shuma (investimet faza e 2-të e zbatimit)</b>	<b>8,800,000</b>	<b>700,000</b>	<b>9,500,000</b>
<b>2. Fuqizimi institucional</b>			
<b>Masat shoqëruese</b>	<b>1,000,000</b>		<b>1,000,000</b>
<b>Shuma e fazës së dytë të zbatimit</b>	<b>9,800,000</b>	<b>700,000</b>	<b>10,500,000</b>
Baza e çmimeve për të gjithë koston është viti 2008			

Fondi rezervë mund të përdoret për masat e treguara në këtë tabelë duke përjashtuar masat shoqëruese. Përdorimi i fondit rezervë të mbetur që nuk ka qenë i nevojshëm për këto masa do të bihet dakord ndërmjet Ministrisë së Financave dhe KfW-së.

#### ANEKSI 5

##### UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.kfw-entwicklungsbank.de/ebank/DE\\_Home/I/Download\\_Center/PDF-Dokumente\\_Richtlinien/Consultingrichtlinie\\_Englisch\\_August\\_2010\\_Internetversion.pdf](http://www.kfw-entwicklungsbank.de/ebank/DE_Home/I/Download_Center/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_Englisch_August_2010_Internetversion.pdf)

#### ANEKSI 6

##### UDHËZIME PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNËS, SIPAS BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.kfw-entwicklungsbank.de/ebank/DE\\_Home/I/Download\\_Center/PDF-Dokumente\\_Richtlinien/Vergaberichtlinie\\_Englisch\\_10\\_2010\\_Internet.pdf](http://www.kfw-entwicklungsbank.de/ebank/DE_Home/I/Download_Center/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_Englisch_10_2010_Internet.pdf)

## ANEKSI 7 I MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Punonjësi përgjegjës: Jean-Pierre Vanherpe  
Tel.: +49 30 – 20264 – 5184  
Email: Jean-Pierre.Vanherpe@kfw.de

Procedura e disbursimit

Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë  
Menaxhimi i mbetjeve te ngurta në Juglindje të Shqipërisë

8.8 milionë euro (huaja) 3.4, milionë euro dhe kontributi financiar 5.4, milionë për investime  
Referenca e KfW-së: 2008 65 170

1.0 milion euro për masat shoqëruese  
Referenca e KfW-së: 2010 70 176

### 1. HYRJE

Ky aneks përcakton procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipërpërmendur. marrëveshja e veçantë, duke përfshirë këtë aneks i ofrohet të gjithë personelit të huamarrësit, përfituesit, ose agjencisë së zbatimit të projektit/programit (pala e autorizuar) dhe çdo palë tjetër e përfshirë me disbursimet.

KfW-ja disburson huat dhe kontributet financiare të pashlyeshme (fondet) me kërkesë të palës së autorizuar në pajtim me progresin e projektit/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallrat dhe shërbimet specifike mbi bazën e “Marrëveshjes së veçantë”, që i përket marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet përkatëse të rezervuara formojnë kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja, menjëherë sapo të përmbushen parakushtet për disbursimin.

### 2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### 2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;
- numërtohen me numra të njëpasnjëshëm; dhe
- nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar, të cilët janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe për të cilët KfW-ja ka marrë modelet e nënshkrimeve (për shembull, shihni shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesa origjinale për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë pas kësaj, i shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja lirohet nga pala e autorizuar nga përgjegjësia për çdo dëm, që rrjedh nga transmetimet e rreme, veçanërisht për shkak të gabimeve në transmetim, abuzimit, keqkuptimit ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e marrë përsipër (monedha e huaj), KfW-ja e debiton huamarrësin ose përfituesin me ato shuma që priten nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet rastësore.

2.4 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transmetuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, detyrimi i saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

### 3. DISPOZITA TË VEÇANTA

3.1 Pala e autorizuar është Shoqata Rajonale e Korçës për Menaxhimin e Mbetjeve (KRWM).

3.2 Procedura për t’u zbatuar

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet të specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.



Fondet e mbetura të specifikuara në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 shërbimet e konsulencës disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti).

Kontributi financiar (5.4 milionë euro) dhe huaja (3.4 milionë euro) të dhëna nga KfW-ja (referenca e KfW-së nr. 2008 65 170), do të përdoret vetëm për të financuar kontratat për mallrat dhe shërbimet. Pagesat, sipas këtyre kontratave disbursohen, sipas specifikimit në marrëveshjen e veçantë I.3.

Kontributi financiar për masat shoqëruese i dhënë nga KfW-ja (1.0 milion euro) do të përdoret vetëm për të financuar kontratat për shërbimet e ekspertëve (referenca e KfW-së nr. 2010 70 176).

### 3.3 Procedurë disbursimi e drejtpërdrejtë (konsulenti)

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën B), duke treguar emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësi të plota për bankën).

#### 3.3.1 Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, kurdoherë që zbatohen:

- kopje e faturës së konsulentit;
- prova për bazën kontraktuale të rënë dakord për llogaritjen e çmimeve në rastin e rritjes së çmimit;
- lista e shpenzimeve për koston e rimbursueshme që tregojnë datën, përshkrimin, çmimin, normën e këmbimit të shpenzimeve, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti, e cila deklaron që informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

#### 3.3.2 Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat, duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe mund të këqyren kurdoherë nga KfW-ja ose palët e tjera të udhëzuara nga KfW-ja për këtë (p.sh. auditët).

### 3.4 Procedurë disbursimi e drejtpërdrejtë (mallrat dhe shërbimet)

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (nënshkrimet e autorizuar) (shihni shtojcën C), që tregon përkatësisht emrin e përfituesit, porosinë e pagesave (hollësi të plota bankare) dhe pjesën e faturës që duhet të paguhet nga huaja dhe granti.

Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, kurdoherë që zbatohen:

- Kopje të faturave tregtare për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen. Faturat duhet të përpiqen në pajtim me specifikimet e parashikuara në kontratat për mallrat dhe/ose shërbimet.

Përveç kësaj, nëse nuk kontraktohet asnjë konsulent zbatimi dhe shkallëzimi i çmimit është faturuar: prova të bazës së miratuar kontraktuale për llogaritjen e çmimit.

- Kopje të shënimeve të ngarkesës, nëse tarifat e transportit duhet të paguhet dhe nuk përfshihen në shumën kontraktuale ose nëse paguhet me koston faktike.

- Për furnizimet nga jashtë shtetit, kopje të dokumenteve të dërgesës (p.sh. fatura e vendosjes në bord, dokumenti shoqërues tokësor ose ajror), duke përcaktuar emrin dhe flamurin e anijes ose tipin dhe shtetësinë e një mjeti tjetër transporti, llojin dhe sasinë e mallrave të dërguara, si dhe vendin dhe datën e dërgesës.

- Sipas rastit, kopje të garancive bankare dhe certifikatave të pranimit që duhet të jepen në pajtim me kontratat për mallrat dhe/ose shërbimet, dhe certifikatat mbi përparimin e projektit.

- Një konfirmim për faturën nga konsulenti i kontraktuar për zbatimin e projektit, që përcakton:

- që mallrat dhe shërbimet e faturuara janë dhënë rregullisht dhe pagesa e tyre është e kërkueshme;

- që të gjitha dokumentet që duhet të paraqiten (duke përfshirë garancitë) janë në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloret/standardet e KfW-së;

- që të gjitha parakushtet për zbatimin e klauzolës së shkallëzimit të çmimit janë përmbushur dhe rritja e çmimit të faturuar është e justifikuar.

#### 3.4.1 Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të mund të këqyren kurdoherë nga KfW-ja ose palët e tjera të udhëzuara nga KfW-ja për këtë (p.sh. auditët).

3.5 Njoftimet e debive u shpërndahen automatikisht çdo muaj me postë të adresuarve të marrëveshjes së veçantë dhe palëve të tjera të përfshira, siç i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

Nëse pala e autorizuar i ka komunikuar një adresë email-i KfW-së, lajmërimet debitë do të dërgohen çdo ditë.

Jeni të lutur të kontaktoni punonjësën e KfW-së të përmendur më sipër nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

- A) Shembull i një letre që cakton nënshkruesit e autorizuar.
- B) Formular kërkesë për tërheqjen procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë konsulentë.
- C) Formular kërkesë për tërheqjen e procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë, mallra dhe shërbime.

**SHTOJCA A**  
**SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR**

Nga: \_\_\_\_\_  
(Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit)

Drejtuar:

KfW Bankengruppe  
Attn: LGB  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë  
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë

8.8 milionë euro (huaja) 3.4, milionë euro dhe kontributi financiar 5.4, milionë për investime  
Referenca e KfW-së: 2008 65 170

1.0 milion euro për masat shoqëruese  
Referenca e KfW-së: 2010 70 176

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e përmendur më sipër, ne do të donim t'ju informojmë që personat, modeli i certifikuar i nënshkrimit të të cilëve është në këtë letër, janë të autorizuar të nënshkruajnë së bashku kërkesat për tërheqje në emër të huamarrësit/përfituesit/agjencisë së zbatimit të programit/projektit

Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

b)

Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

c)

Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

Të gjitha njoftimet e mësipërme (sipas rastit) që kanë nënshkrimet e punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje sipas kësaj huaje/kontributi financiar, revokohen.

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar, sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit, datë



Shënim. Nëse një kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës, autorizimi duhet ta shprehë këtë qartë. Nëse nënshkruesit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohen nënshkrimet e përbashkëta, kjo duhet të shprehet, gjithashtu, qartë.

## SHTOJCA B

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe  
TM a  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Lënda: TM a –  
Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë  
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë

8.8 milionë euro (huaja) 3.4, milionë euro dhe kontributi financiar 5.4, milionë për investime  
Referenca e KfW-së: 2008 65 170

1.0 milion euro për masat shoqëruese  
Referenca e KfW-së: 2010 70 176

Kërkesë tërheqjeje nr. ....  
Procedurë disbursimi e drejtpërdrejtë (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e specifikuar më poshtë, kopje të të cilave u janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhet:

Artikulli	Kontratë konsulence	Faturë konsulenti	Monedha/shuma
Nr.*	datë .....	nr. ....	
	me .....	datë .....	

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme paguhet nga huaja/kontributi financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni, si më poshtë:

Monedha/shuma  
.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)  
.....

Nr. i llogarisë: .....IBAN (sipas rastit)  
Emri i bankës: ..... kodi BIC: .....  
Banka korrespondente:\* ..... kodi BIC: .....

Si provë shoqëruese, një kopje e faturës përkatëse është bashkangjitur, sipas rastit, së bashku me provat e bazën e rënë dakord në kontratë për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për të rimbursueshmet.

\* Artikulli i “Listës së mallrave dhe shërbimeve”

\* Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk është në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesa të veçanta kërkohen për çdo monedhë të kërkuar.

Ne presim njoftimet tuaja të debisë për disbursimet e bëra prej jush.

.....

(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

**SHTOJCA C**

Nga:

\_\_\_\_\_

(Adresa e palës së autorizuar)

\_\_\_\_\_

(datë)

KfW Bankengruppe  
TM a  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Lënda: TM a – Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë  
Menaxhimi i mbetjeve te ngurta në Juglindje të Shqipërisë

8.8 milionë euro (huaja) 3.4, milionë euro dhe kontributi financiar 5.4, milionë për investime  
Referenca e KfW-së: 2008 65 170

1.0 milion euro për masat shoqëruese  
Referenca e KfW-së: 2010 70 176

Kërkesë tërheqjeje nr. ....  
Procedurë disbursimi e drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat/grafikët e masave të specifikuar më poshtë, kopje të të cilave u janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Artikulli Nr.*	Kontratë për mallra/shërbime datë .....	Faturë nr. ....	Shuma
	me .....	datë .....	
	ose grafiku i masave (punët e kontraktuara të ndërtimit), datë .....	ose grafiku i datës .....	

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme paguhen nga huaja/kontributi financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni, si më poshtë:

Monedha/shuma	Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)	Numri i llogarisë/IBAN, sipas rastit	Banka/kodi BIC:	Banka korrespondente:*/kodi BIC:

Ato shumat të faturave që nuk paguhen nga huaja/kontributi financiar janë paguar prej nesh, si më poshtë:

\* Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

\* Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk është në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesa të veçanta kërkojnë për çdo monedhë të kërkuar.



Monedha/shuma	Përfituesi (shoqëria)	Data e porosisë së pagesës dhe banka paguese
.....	.....	.....
.....	.....	.....
.....	.....	.....

Si provë mbështetëse, në bashkëlidhim – sipas rastit (jeni të lutur t'i referoheni procedurës së disbursimit të aneksit të marrëveshjes së veçantë)

- ..... fatura e konsulentit (sipas termave të kontratës për pagesën)
- ..... faturat e furnitorit (kopje) për çmimin bazë,  
( ) që përmban një konfirmim nga konsulenti
- ..... faturat e konsulentit (kopje) për një rritje çmimi mbi bazën e një klauzole eksalimi çmimi  
( ) që përmban një konfirmim nga konsulenti
- ( ) prova për bazën e llogaritjes
- ..... shënime për ngarkesën (kopje)
- ..... dokumente dërgese (kopje)
- ..... garanci bankare (kopje)
- ..... certifikata pranimi
- ..... certifikata për përparimin e projektit
- ..... lista e shpenzimeve (fuqia punëtore)
- ..... (.....) që përmban një konfirmim nga konsulenti (sipas rastit)
- ..... dokumente të tjera: .....

Ne presim njoftimet tuaja të debisë për disbursimet e bëra prej jush.

.....  
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

#### ANEKSI 8

#### PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTIMIT, DUKE PËRFSHIRË TABELËN E MONITORIMIT

##### A) ELEMENTE BAZË DHE MJEDISI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Agjencia e zbatimit të projektit (KRWM) raporton (sipas rastit, me mbështetjen nga një konsulent) dy herë në vit nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit (së pari në raportin e fundit semestral të vitit 2010) dhe çdo vit nga një vit pas lejimit të çështjeve të mëposhtme.

Sipas rastit, jeni të lutur të tregoni zhvillimin me faza statistikore kohore. Shpjegoni çdo zhvillim të veçantë. Vlerësoni ndikimin e tyre në suksesin e qëndrueshëm të projektit.

1. A ka mbetur KRWM-ja një shoqëri e qëndrueshme?

- Pasqyrat financiare (p.sh. llogarinë e fitimeve dhe humbjeve, bilancin, deklaratimet vjetore mundësisht të certifikuar ose pasqyrat e të ardhurave).

- A ka gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm? Zhvillimi i pagesave të aksionarëve.

- Zhvillimi dhe ndryshimet në lidhje me aksionarët e KRWM-së.

- A janë futur fusha të reja operimi që nga vlerësimi i projektit?

- Zhvillimi i personelit dhe ndryshimet (numri i personelit, përshkrimet e punës etj.).

- Të dhëna të tjera në varësi të çështjes individuale: veçanërisht, të dhëna specifike për sektorin ose tipin e projektit (p.sh. shifrat e shitjeve, përdorimi i kapacitetit, norma e kompensimit të kostos, humbjet në shpërndarje, kostoja e prodhimit, zhvillimi i tarifave, llogaritë e mbetura).

2. A janë zhvilluar kushtet e përgjithshme ekonomike dhe sektoriale, dhe tregu sipas parashikimit?

- Roli i konkurrencës dhe i ofruesve të shërbimeve përkatëse të projektit (shërbimet e dhëna nga shoqëritë bashkiake ose private, cilësia, zhvillimi i çmimit, përgjegjshmëria etj.).

- Të dhënat e tjera që varen nga rasti individual (specifik sipas sektorit ose të dhëna në lidhje me tipin e projektit), p.sh. zhvillimi rajonal i popullatës, zhvillimi i kushteve sektoriale, pjesa në treg.

3. A kanë mbetur ndikimet mjedisore të projektit të pranueshme? (Jeni të lutur të rendisni ndikimet veçmas për zbatimin dhe operimin.)

- A ka pasur ndryshime në legjislacionin mjedisor që ka të bëjë me projektin?

- A janë dhënë mbi një bazë të arsyeshme aprovimet e kërkuara nga legjislacioni mjedisor?

- A janë përmbushur standardet mjedisore të autorizimit, dokumentet inxhinierike të hollësishe, koncepti operacional, plani dhe detyrimet e menaxhimit mjedisor (sipas rastit)?

- A ka pasur ankime ose padi në lidhje me ndikimet mjedisore?

- A janë garantuar kontrollet e synuara?

- Ç'masa të tjera të mbrojtjes mjedisore janë planifikuar?

#### B) GJENDJA E ZBATIMIT DHE GRAFIKU KOHOR

Agjencia e zbatimit të projektit (KRWM) raporton (sipas rastit, me mbështetjen nga konsulentët) çdo semestër nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit në lidhje me çështjet e mëposhtme. PEA/konsulenti regjistron të gjitha masat e planifikuara të projektit dhe kontratat kryesore dhe i përditëson ato në çdo raport.

1. Cila është gjendja e zbatimit të projektit, si i tillë dhe i aktiviteteve të veçanta të projektit? (Hollësitë mund të jepen në tabela që i bashkëngjiten raportit.)

- Detyra e konsulentit: dhënia e kontratës, afatet, tipi i shërbimit të dhënë, fuqia punëtore e punësuar në nivel lokal dhe në mbështetje.

- Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet afatet, marrëveshja për specifikimet, publikimi; rezultati dhe vlerësimi i ofertave; propozimi për dhënien e kontratës; konsultimi për kontratat për mallrat dhe shërbimet.

- Furnizimi me mallra dhe dhënia e shërbimeve (të detajuara sipas listës së përbërësve të projektit ose kontratave të furnizimit).

- Mallrat: tipi dhe volumi, afatet e dorëzimit, garancitë e dhëna, inspektimi përfundimtar i prodhuesit, pranimi.

- Transportet: tipi dhe volumi, kohëzgjatja, siguracioni, ruajtja në vendin e ndërtimit.

- Puna e ndërtimit: tipi dhe volumi, makineria që përdoret, fuqia punëtore e angazhuar; pranimi i punës së ndërtimit.

- Puna e instalimit: tipi dhe volumi, makineria që përdoret, fuqia punëtore e angazhuar; personeli i furnitorëve.

- Instruktimi i personelit: tipi dhe objekti, numri, kualifikimi i personelit operues, trajnimi i avancuar te furnitorët.

- Komisionimi/vënia në funksionim: pranimi përfundimtar, provat e testimit, rezultatet operative, korrigjimet. Ngjarjet e garancisë (tipi dhe objekti, pasojat).

- Aktivitete të tjera: studime paraprake, dhënia, tipi dhe objekti, afatet, personeli, materiali, trajnimi i jashtëm, pranimi.

2. A mund të vihet në operim projekti brenda afatit të synuar?

Përditësimi i aneksit 2 (vështrim i përgjithshëm i investimit) dhe 3 (grafiku kohor) i marrëveshjes së veçantë; krahasimi i përmbushjes së objektivave; shkaqet e shmangieve dhe masat për korrigjimin e tyre; vlerësimi i ndikimit të devijimeve në fillimin e operacionit; vlerësimi i efektivitetit të masave të synuara korrigjuese; pasojat financiare dhe të zhvillimit.

3. A mund të përmbushë detyrat e saj organizata e projektit, veçanërisht funksionet e saj bashkërenduese?

Krahasimi i arritjes së objektivave të organizatës së projektit; shkaqet dhe vlerësimi i devijimeve; cilat masa korrigjuese, sipas rastit, janë të nevojshme?

#### C) KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

Agjencia e zbatimit të projektit (KRWM) raporton (sipas rastit, me mbështetjen nga konsulentët) çdo semestër nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit në lidhje me çështjet e mëposhtme.





(Përditësimi i aneksit 4 të marrëveshjes së veçantë; krahasimi i arritjes së objektivave; shkaqet e shmangieve dhe masat korigjuese, përveç kur janë shpjeguar te B; Pasojat e shmangies për koston e plotë dhe financimi i projektit dhe leverdia e tij tregtare.)

1. A është siguruar financimi i projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes?

2. Cilat pjesë të fondeve të plota të projektit dhe të huas FC (me hollësi) janë përdorur, justifikuar dhe disbursuar në fund të periudhës nën rishikim?

3. Në cilën shumë janë mbledhur fondet me interesa të ndryshme dhe si janë përdorur?

#### D) OPERIMI I PROJEKTIT DHE EFEKTIVITETI I PROJEKTIT

Agjencia e zbatimit të projektit (KRWM) raporton (sipas rastit, me mbështetjen e një konsulenti) çdo semestër nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit deri në një vit pas fillimit të operacionit, më pas dy herë në vit në lidhje me çështjet e mëposhtme (përditësimi i aneksit 1 - Skica e marrëveshjes së veçantë).

1. A janë duke u përmbushur faktorët mbi arritjen e rezultateve, objektivat e modulit dhe objektivat e programit?

- Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatës së fillimit sipas përshkrimit në aneksin 1 në lidhje me prezumimet. Shkaqet për devijimet. Vlerësimi i pasojave të devijimeve për suksesin e qëndrueshëm të projektit. Cilat aktivitete duhet të kryhen për përmbushjen e faktorëve? Vlerësimi i efektivitetit dhe implikimet financiare.

2. A mund të arrihen rezultatet, objektivat e modulit dhe objektivat e programit? Kur?

- Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatës së fillimit sipas përshkrimit në aneksin 1 në lidhje me rezultatet dhe objektivat. Shkaqet për devijimet. Vlerësimi i pasojave të devijimeve për suksesin e qëndrueshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për përmbushjen e objektivave? Vlerësimi i efektivitetit dhe implikimet financiare.

3. A ka pasur apo pritet ndonjë zhvillim që rrezikon suksesin e qëndrueshëm të projektit (duke përfshirë cilësinë e marrëdhënies ndërmjet huamarrësit, PEA-s nga njëra anë dhe grupit të synuar dhe çdo institucioni bashkëpunues apo firmave nga ana tjetër)?

- Merrni parasysh deklaratimet e bëra sipas pikës A.

4. A janë bërë të nevojshme aktivitetet shtesë që duhet të përfshihen në hartimin e projektit? A është bërë i tepërt ndonjë aktivitet i projektit?

- Deklaroni aktivitetet, duke treguar në shkallën e mundur: natyrën, përmbajtjen, kohëzgjatjen, fillimin/fundin, agjencinë përgjegjëse, procedurën e mundshme të prokurimit, koston dhe financimin.

#### E) TABELA E MONITORIMIT TË PROJEKTIT

Tabela e mëposhtme në lidhje me monitorimin e treguesve, rreziqeve dhe rezultateve i bashkëngjitet çdo raporti tremestral. PEA/konsulenti është i lirë ta ndryshojë, sipas rastit dhe KfW-ja ka lejen ta ndryshojë atë sipas rastit në lidhje me detyrimet e raportimit.

**TABELA E MONITORIMIT**

<b>Objektivi i Përgjithshëm</b>				
Kontribimi për përmirësimin e shëndetit publik, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mënjanimi i ndotjes mjedisore				
<b>Prezumimet për arritjen e Objektivit të Përgjithshëm</b>		<b>R</b>	<b>I</b>	<b>Vlerësimi i @</b>
A	Fushatat e ndërgjegjësimit kontribuojnë për sensibilizimin e popullatës për mbrojtjen e mjedisit	m	m	
B	Financimi i mjaftueshëm do të jepet nga Bashkitë për të qenë mbrojtëse nga pikëpamja mjedisore pranë vendeve ekzistuese të mbeturinave.	h	m	
<b>Objektivi i Projektit</b>				
Zbatimi i një sistemi të shëndoshë menaxhimi të mbeturinave në rajonin e Korçës që mbron burimet natyrore, mjedisin dhe shëndetin e njeriut				
<b>Treguesit për Objektivin e Projektit</b>		<b>Status i @</b>		
1	Bashkitë dhe Komunitatet që marrin pjesë në Shoqatën Rajonale të Korçës për Menaxhimin e Mbeturinave Përfaqësojnë të paktën 70% të popullatës së rajonit			
2	Norma e mbledhjes së mbeturinave në zonat urbane është të paktën 90% e të gjithë mbeturinave			
3	Norma e mbledhjes së mbeturinave në zonat rurale është të paktën 70% e të gjithë mbeturinave			
4	Disponimi i rregullt i 100% i mbeturinave të pariciklueshme në gropën e mbeturinave			
5	Mbulimi i kostos operative me 80% nga tarifat e mbeturinave			
<b>Prezumimet për arritjen e Objektive të Projektit</b>		<b>R</b>	<b>I</b>	<b>Vlerësimi i @</b>
A	Bashkitë dhe Komunitatet vazhdojnë të bashkëpunojnë me KRWM-në	h	m	
B	KRWM-ja realizon punësimin e personelit të kualifikuar	m	n	
C	Rritja e tarifave është politikisht e pranueshme	h	m	
<b>Rezultati 1</b>				
Gropa mbeturinash të mjaftueshme dhe kapacitete logjistike për të siguruar hedhjen e mbeturinave duke ruajtur mjedisin				
<b>Masat për Rezultatin 1:</b>		<b>Status i @</b>		
1.1	Ndërtimi i një gropë të re në Maliq			
1.2	Ndërtimi i vendeve të transferimit			
1.3	Dorëzimi i kontejnerëve dhe kamionëve të përshtatshëm			
1.4	Dhënia e pajisjeve të lëvizshme për gropat e plehrave			
<b>Rezultati 2</b>				
Bashkitë dhe Komunitatet kanë përmirësuar mbledhjen e mbeturinave dhe transportin e tyre				
<b>Masat për Rezultatin 2:</b>		<b>Status i @</b>		
2.1	Dhënia e kamionëve të mbledhjes			
2.2	Prokurimi i kontejnerëve			
<b>Rezultati 3</b>				
Shoqata e Menaxhimit të Mbeturinave është e trajnuar rregullisht dhe e pajisur për të përmbushur detyrat e saj				
<b>Masat për Rezultatin 3:</b>		<b>Status as of @</b>		
3.1	Masat shoqërore			
<b>Rezultati 4</b>				
Gropat ekzistuese të mbeturinave mbyllen rregullisht				
<b>Masat për Rezultatin 4:</b>		<b>Status i @</b>		
4.1	Shërbimet e ndërtimit në vendet ekzistuese			
<b>Masat e kërkuara për më shumë se një Rezultat</b>				
1	Shërbimet e ndërtimit në vendet ekzistuese	<b>Status i @</b>		
<b>Prezumimet për arritjen e Rezultateve</b>		<b>R</b>	<b>I</b>	<b>Vlerësimi i @</b>
A	Merret leja e ndërtimit	m	m	
B	Gropa e mbeturinave mbetet e pakundërshtuar	m	m	
<b>Marrëveshjet e veçanta të zbatimit</b>				
1	Para publikimit të tenderit për ndërtimin e Gropës sanitare në fazën 2 të zbatimit, Merret leja e ndërtimit për gropën e re në Maliq	<b>Status i @</b>		
2	Para kontraktimit të shërbimeve të ndërtimit dhe para Disbursimit të parë të fondeve të parashikuara për Fazën 2 të zbatimit, përmyllët procesi i shpronësimit të tokës	<b>Status i @</b>		
<b>Treguesit të grupit të adresuar</b>		<b>Status i @</b>		
1	Grupi i adresuar: numri i përdoruesve (2 vjet pas zbatimit të projektit)			
2	% dobësisë së grupit të adresuar			

R = risik; I = influencë; h = lartë; m = mesëm; l = ulët



**LIGJ**  
**Nr. 103/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E KOMANIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8074, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

(Numri i operacionit 43125)

**MARRËVESHJA E HUAS**  
**(PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË SË DIGËS SË HIDROCENTRALIT TË KOMANIT)**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**(PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË) DHE**  
**BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Kjo projekt marrëveshje huaje është përgatitur vetëm për qëllime të diskutimit paraprak. Dispozita të tjera shtesë mund t'i shtohen asaj dhe teksti ekzistues i nënshtrohet ndryshimeve dhe miratimit përfundimtar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Datë [ \_\_\_\_\_ ]

**MARRËVESHJE**  
**ME DATË [ \_\_\_\_\_ ], NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA**  
**MINISTRIA E SAJ E FINANCAVE (HUAMARRËSI) DHE BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM**  
**DHE ZHVILLIM (BANKA)**

**HYRJE**

*Ndërsa*, Banka është themeluar për të dhënë financime për projekte të posaçme për të nxitur tranzicionin drejt ekonomive të tregut të hapur dhe për t'i dhënë shtysë nismave private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut dhe janë të përkushtuara ndaj këtyre parimeve;

*Ndërsa*, Huamarrësi ka për qëllim që të vërë në jetë projektin (siç ai përshkruhet në programin 1 të hartuar për të ndihmuar në financimin e programit të investimeve të entitetit të projektit (siç është përkufizuar më poshtë) me qëllim forcimin (rritjen) e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri;

*Ndërsa*, projekti do të kryhet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (entiteti i projektit) me ndihmesën financiare nga huamarrësi;

*Ndërsa*, Huamarrësi ka kërkuar ndihmesë nga Banka për financimin e një pjesë të projektit;

*Ndërsa*, Sekretariati Shtetëror Zvicëran për çështjet ekonomike (Swiss State Secretariat for Economic Affairs) ka dhënë një grant në shumën euro 5,330,000 për përgatitjen e studimit të realizueshmërisë (fizibilitetit) dhe financimin e disa pjesëve të projektit;

*Ndërsa*, Huamarrësi ose entiteti i projektit, si të jetë rasti, kanë kontraktuar dy hua me një vlerë totale prej euro 41,320,000 nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim dhe nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe kanë për qëllim të kontratojnë një hua nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (“bashkëfinancuesit” dhe secili një “bashkëfinancues”) për të ndihmuar në financimin e disa pjesëve të programit të investimeve për sektorin shqiptar të hidroenergjisë, pjesë e të cilit është edhe ky projekt, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara e që do të parashikohen, siç mund të jetë rasti, në marrëveshjet (marrëveshjet e bashkëfinancimit) ndërmjet Huamarrësit dhe bashkëfinancuesve përkatës; dhe

*Ndërsa*, Banka ka rënë dakord mbi bazën, ndërmjet të tjerash, e sa më sipër, për t’i dhënë një hua Huamarrësit në shumën euro 12,700,000, sipas termave dhe kushteve të parashikuara apo të referuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen e projektit me datën e këtushme ndërmjet entitetit të projektit dhe Bankës (“marrëveshja e projektit”, siç përcaktohet në termat dhe kushtet standarde dhe siç është rënë dakord me Huamarrësin).

Tani, si rrjedhim, palët bien dakord për sa vijon:

## Neni I

### Termt dhe kushtet standarde, përkufizimet

#### Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 përfshihen këtu dhe bëhen të zbatueshme për këtë marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe pasojë sikur të ishin parashikuar plotësisht këtu (këto dispozita do të quhen në vazhdim “Termt dhe kushtet standarde”).

#### Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kudo që janë përdorur në këtë marrëveshje (duke përfshirë këtu hyrjen dhe programet), përveçse kur deklarohet ndryshe apo kur konteksti kërkon ndryshe, termt e përkufizuar të hyrja kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre atje, termt e përkufizuar në termt dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre atje dhe termt në vijim kanë këto kuptime:

“Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit, përveçse siç përcaktohet në seksionin 2.04.

“Vit fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon në 1 janar të çdo viti.

“Pasoje materiale e padëshiruar (efekt material i padëshiruar)” nënkupton një pasojë të padëshiruar materiale mbi:

a) aftësinë e entitetit të projektit për të përmbushur apo për të vepruar në përputhje me cilindo nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes së projektit ose sipas marrëveshjes plotësuese të huas;

b) aftësinë e entitetit të projektit për të vënë në jetë ose operuar qëndrueshmërinë e projektit në mënyrën e parashikuar nga kjo marrëveshje, apo sipas marrëveshjes së projektit ose sipas marrëveshjes së nënhuas; ose

c) punën, operacionet dhe kushtet financiare të entitetit të projektit.

“Marrëveshja e nënhuas” nënkupton marrëveshjen e huas që do të arrihet ndërmjet entitetit të projektit dhe Ministrisë së Financave të Shqipërisë, në përputhje me seksionin 3.01(a), siç kjo marrëveshje mund të ndryshohet kohë pas kohe me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

#### Seksioni 1.03. Interpretimi



Në këtë marrëveshje, një referim te një nen, seksion ose program i veçantë, përveçse kur deklarohet ndryshe në këtë marrëveshje, do të interpretohet si një referim ndaj atij neni ose seksioni të, ose programi ndaj, kësaj marrëveshje.

## Neni II Termet kryesorë të huas

### Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

Banka bie dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara apo të referuara në këtë marrëveshje, shumën prej euro 12,700,000.

### Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të huas

a) Shuma minimale për tërheqje do të jetë euro 100,000.

b) Shuma minimale për parapagim do të jetë euro 1,000,000.

c) Shuma minimale për anulim do të jetë euro 1,000,000.

d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 25 mars dhe 25 shtator të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi do ta shlyejë huan në 26 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) në secilën datë të pagesës së interesit, duke qenë data e parë e pagesës së huas në datën e pagesës së interesit menjëherë pas përvjetorit të dytë të kësaj marrëveshje.

2. Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se: i) Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e huas përpara datës së parë të pagesës së huas të përcaktuar në këtë seksion 2.02 (e); dhe ii) Banka, me kërkesë të Huamarrësit, e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë të përcaktuar në seksionin 2.02 (f) më poshtë për në një datë e cila bie pas datës së parë të pagesës së huas, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të bërë në datën apo pas datës së parë të pagesës së huas do të shpërndahet për t'u ripaguar në shumën të barabarta nëpër këstet e tjera të cilat bien pas datës së kësaj tërheqjeje (duke rregulluar Banka shumën e caktuar në këtë mënyrë si të jetë e nevojshme për të përfutur numra të plotë në çdo rast). Banka, kohë pas kohe, do të njoftojë Huamarrësin për këto shpërndarje.

f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë 31 dhjetor 2016 ose një datë e mëvonshme siç mund të bihet dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

g) Huaja i nënshtrohet një norme të luhatshme (variabël) interesi në përputhje me seksionin 3.04(b) të termave dhe kushteve standarde.

h) Norma e tarifës së angazhimit do të jetë 0.5 % në vit për t'u llogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde.

i) Norma e komisionit fillim-mbarim do të jetë 1 % e shumës maksimale të principalit të huas (euro 127,000) dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde.

j) Tarifa e parapagimit do të jetë 0.125 % e shumës së principalit të huas që po parapaguhet, e pagueshme në përputhje me seksionin 3.07 të termave dhe kushteve standarde.

k) Tarifa e anulimit do të jetë 0.125 % për t'u përlllogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.08 të termave dhe kushteve standarde.

l) Norma e interesit të shkaktuar nga paaftësia paguese do të jetë 2 % në vit plus marzhin, për t'u përlllogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.09 të termave dhe kushteve standarde.

m) Paga e principalit, interesi dhe detyrimeve të huas do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të termave dhe kushteve standarde dhe sipas seksionit 3.11 të termave dhe kushteve standarde.

### Seksioni 2.03. Tërheqjet

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e programit 2 për të financuar: 1. shpenzime të bëra (ose për t'u bërë nëse banka bie dakord) në lidhje me kosto të arsyeshme për mallra dhe punime të nevojshme për projektin; dhe 2. për komisionin fillim-mbarim.

### Seksioni 2.04. Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqje

Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit për qëllim të marrjes së ndonjë veprimi të kërkuar apo të lejuar sipas dispozitave të seksionit 2.03 (a) dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02 të kushteve dhe termave standardë.

### Neni III Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01. Dispozita të tjera pohuese të projektit

Veç sa janë marrë përsipër në mënyrë të përgjithshme në parashikimet e bëra në nenet IV dhe V të termave dhe kushteve standarde, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) do të vërë në dispozicion të entitetit të projektit, në pajtim me marrëveshjen e nënhuas, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, fondet e huas me terma dhe kushte të pranueshme për Bankën;

b) do të ushtrojë të drejtat e tij sipas marrëveshjes së nënhuas, në një mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Bankës, të veprojë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe të arrijë qëllimet për të cilat jepet huaja;

c) përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të transferojë, ndryshojë apo shtojë, shfuqizojë apo heqë dorë nga cilado dispozitë e marrëveshjes së nënhuas;

d) do të bëjë që entiteti i projektit të përmbushë të gjitha detyrimet e veta sipas marrëveshjes së projektit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, detyrimet e tij në lidhje me:

1. mbajtjen dhe operimin e një njësie për zbatimin e projektit;
2. prokurimin e mallrave dhe punimeve në lidhje me projektin;
3. çështjet mjedisore dhe sociale;
4. mbajtjen dhe përdorimin e këshilltarëve (konsulentëve) për të ndihmuar në zbatimin e projektit;
5. përgatitjen dhe vënien në jetë të planit të punës dhe planit të investimeve për entitetin e projektit;
6. përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve mbi çështje që lidhen me projektin dhe me operacionet e entitetit të projektit;

7. mbajtjen e procedurave, regjistrave, raporteve dhe llogarive, përgatitjen, kontrollin financiar (auditimin) dhe paraqitjen ndaj Bankës të deklaratave financiare, si edhe dhënien ndaj Bankës të çdo informacioni me rëndësi në lidhje me projektin ose operacionet e entitetit të projektit; dhe

8. pajtueshmërinë në lidhje me të gjitha dispozitat që lidhen me aspektet financiare dhe operacionale të projektit dhe të entitetit të projektit,

secila siç parashikohen në seksionet përkatëse të marrëveshjes së projektit; dhe

e) do të mbështesë entitetin e projektit, do të sigurojë ose do të bëjë që të sigurohen fonde për entitetin e projektit, si dhe kur i duhen atij (qoftë në formën e një investimi kapital një huaje apo ndryshe) për të arritur përfundimin e projektit dhe/ose për të plotësuar të gjitha detyrimet financiare të entitetit të projektit në lidhje me projektin;

f) do të mbështesë rregullime të tilla të tarifave siç mund të kërkohen për përmbushjen nga ana e entitetit të projektit të detyrimeve të tij sipas marrëveshjes së projektit dhe arritjen nga entiteti i projektit të rekuperimit të plotë të kostove për shërbimet e tij;

g) nuk do të ndërmarrë apo nuk do të bëjë që të ndërmerret asnjë veprim që mund të rezultojë në: i) çfarëdo shkrirje, konsolidim ose riorganizim të entitetit të projektit që sipas mendimit të Bankës, mund të ketë një pasojë materiale të padëshiruar; ose ii) një ndryshim të kontrollit në lidhje me entitetin e projektit.

### Neni IV Pezullimi, përsheptimi

Seksioni 4.01. Pezullimi

Sa vijon, janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 7.01(a) (xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm në sektorin në të cilin operon entiteti i projektit ndryshon, pezullohet, abrogohet apo shfuqizohet në një mënyrë e cila, sipas mendimit të Bankës, mund të ketë një pasojë (efekt) material të padëshiruar.

b) Kontrolli i entitetit të projektit t'i ketë kaluar një pale të ndryshme nga Huamarrësi.



c) Entiteti i projektit dështon në përmbushjen e secilës nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes së nënhuas.

Seksioni 4.02. Përshpejtimi i maturimit

Sa vijon, janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 7.06 (f) të termave dhe kushteve standarde:

a) Cilado ngjarje e përcaktuar me hollësi në seksionin 4.01, e cila do të ketë vazhduar për tridhjetë ditë pasi njoftimi i përcaktimit së një ngjarje e tillë ka ndodhur i është dhënë Huamarrësit nga Banka.

#### Neni V Efektiviteti

Seksioni 5.01. Kushtet pararendëse të efektivitetit

Sa vijon, janë përcaktuar me hollësi për qëllimet e seksionit 9.02(c) të termave dhe kushteve standarde, si kushte shtesë ndaj efektivitetit të kësaj marrëveshjeje dhe të marrëveshjes së projektit:

a) Marrëveshja e nënhuas, në formë dhe përmbajtje e kënaqshme për Bankën, është nënshkruar dhe dërguar; dhe

b) Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar këtë marrëveshje.

Seksioni 5.02. Kushtet pararendëse ndaj tërheqjes së parë

Detyrimi i Bankës për të kaluar shumën e tërheqjes së parë të Huamarrësi do t'u nënshtrohet:

a) marrjes paraprake nga Banka; ose

b) sipas vlerësimit ekskluziv të vetë Bankës, heqjen dorë tërësisht apo pjesërisht, si edhe sipas disa kushteve apo pa asnjë kusht, të marrjes nga Banka;

të provave, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për të, se:

i) PIU (siç përcaktohet në marrëveshjen e projektit) është krijuar (ngritur);

ii) Entiteti i projektit ka emëruar një këshilltar (konsulent) të kualifikuar, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës janë të kënaqshme për bankën, për t'i dhënë ndihmesë entitetit të projektit gjatë procurimit dhe gjatë vënies në jetë të projektit;

iii) Plani i zbatimit të projektit dhe strategjia e kontraktimit do të jenë rënë dakord me Bankën; dhe

iv) Llogaritë e projektit do të jenë hapur në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën, në përputhje me marrëveshjen e projektit.

Seksioni 5.03. Opinionet ligjore

a) Për qëllimet e seksionit 9.03(a) të termave dhe kushteve standarde, opinionin këshillues do të jepet në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe sa vijon janë përcaktuar me hollësi si çështje shtesë për t'u përfshirë në këtë opinion që do t'i jepet Bankës:

1. Marrëveshja e nënhuas është autorizuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur në emër të Huamarrësit dhe përbën detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht shtrëngues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me termat e saj.

b) Për qëllimet e seksionit 9.03(c) të termave dhe kushteve standarde, opinionin këshillues do të jepet në emër të entitetit të projektit nga kreu i departamentit juridik (ligjor) të entitetit të projektit dhe sa vijon janë përcaktuar me hollësi si çështje shtesë për t'u përfshirë në këtë opinion që do t'i jepet Bankës:

1. Marrëveshja e nënhuas është autorizuar dhe arritur në mënyrën e duhur në emër të entitetit të projektit dhe përbën detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht shtrëngues të entitetit të projektit, të zbatueshëm në përputhje me termat e saj.

Seksioni 5.04. Përfundimi për shkak të mosrealizimit për t'u bërë efektiv

Data 180 ditë pas datës së kësaj marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

#### Neni VI Të ndryshme

Seksioni 6.01. Njoftimet

Adresat në vijim janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë, Shqipëri  
Në vëmendje: Ministri i Financave  
Faks: +335 4 2228 494

Për Bankën:

European Bank for Reconstruction and Development  
(Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim)  
One Exchange Square  
London EC2A 2JN  
United Kingdom  
Në vëmendje: Njësia e Operimit dhe Administrimit/43125  
Faks: +44-20-7338-6100

Seksioni 6.02. Ndryshimet

Për të shmangur mëdyshjet, seksioni 10.03 i termave dhe kushteve standarde do të zbatohet për këtë marrëveshje sikur të ishte pasqyruar këtu plotësisht dhe pa asnjë paragjykim ndaj seksionit 1.01 të kësaj marrëveshje.

Dëshmitarë këtu, palët, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë bërë që të nënshkruhet kjo marrëveshje në katër kopje e të dorëzohet në Tiranë, Shqipëri në ditën dhe vitin e shkruar së pari më lart.

Republika e Shqipërisë  
Përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga: \_\_\_\_\_  
Emri: Ridvan Bode  
Titulli: Ministër i Financave

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga: \_\_\_\_\_  
Emri: Nandita Parshad  
Titulli: Drejtor/Drejtoreshë, Energjetikë

Programi 1

Përshkrimi i projektit

1. Qëllimi i projektit është që të ndihmojë Huamarrësin në financimin e programit të investimeve të entitetit të projektit për: a) shtratin e rrjedhës së digës dhe zonën e gërryerjeve të digës së hidrocentralit të Komanit; dhe b) masat për mbrojtjen nga shkëmbinjtë, me qëllim forcimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri.

2. Projekti konsiston në pjesët në vijim, subjekt i ndryshimeve që mund të ndodhin e mund të bihen dakord kohë pas kohe nga Banka dhe Huamarrësi:

Pjesa A. Ndërrhyrje rehabilituese në pjesën fundore të digës dhe konsolidimi i bjefit të poshtëm.

Pjesa B. Fuqizimi i masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve; të dyja në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri.

3. Projekti pritet të përfundohet më 31 dhjetor 2015.





## Programi 2

### Kategoritë dhe tërheqjet

1. Tabela e bashkëngjitur ndaj këtij programi parashikon kategoritë, shumën e huas të caktuar për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar në secilën kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më lart, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet të shkaktuara përpara datës së marrëveshjes së huas.

### Bashkëlidhje ndaj programit 2

Kategoria	Shuma e huas e caktuar në monedhën e huas	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1. Mallra dhe punime për pjesën A	euro 10,000,000	100 % e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse
2. Mallra dhe punime për pjesën B	euro 2,573,000	100 % e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse
3. Komisioni fillim-mbarim	euro 127,000	100%
<b>Totali</b>	<b>euro 12,700,000</b>	<b>100%</b>

## LIGJ

Nr. 104/2013

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË GREQISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË PËR PROJEKTIN PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

#### Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP).

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8075, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË GREQISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË, NË LIDHJE ME PROJEKTIN PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK

### HYRJE

Republika e Shqipërisë, Republika e Greqisë dhe Republika e Italisë (në vijim të quajtur “palët” ose veçmas “pala”), përfaqësuar nga qeveritë përkatëse,

1. *në mbështetje* të parimeve të përcaktuara në marrëveshjet për tregtinë dhe investimet ndërkombëtare, të zbatueshme për secilën nga palët, përfshirë Traktatin e Kartës së Energjisë, traktatet e Komunitetit dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë, si dhe nevojën për zgjerimin e mëtejshëm dhe realizimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e energjisë;

2. *në përpyetje* për të promovuar më tej bashkëpunimin e ndërsjellë të favorshëm për garantimin e furnizimit të sigurt me gaz natyror nga burimet e Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme, përfshirë ato të Republikës së Azerbajxhanit, drejt Bashkimit Europian nëpërmjet Republikës së Turqisë;

3. *duke pasur parasysh* që Trans Adriatik Pipeline AG synon të ndërtojë dhe përdorë një linjë interkonjeksioni gazi ndërkufitar që fillon në Republikën e Greqisë në afërsi të kufirit turko-grek, e projektuar për të transportuar gaz natyror përmes Republikës së Greqisë në drejtim të Republikës së Italisë, nëpërmjet Republikës së Shqipërisë;

4. *duke pranuar* faktin se zhvillimi dhe ndërlidhja (në përputhje me marrëveshjet e interkonjeksionit të lidhura për këtë projekt) e sistemit të Gazsjellësit Trans Anatolian dhe e sistemeve të transportit të gazit natyror të palëve me Gazsjellësin Trans Adriatik do të rrisë sigurinë dhe rezervat e furnizimit me gaz natyror, si pasojë e diversifikimit të itinerareve dhe burimeve të furnizimit me gaz natyror drejt Bashkimit Europian;

5. *duke njohur* rolin e rëndësishëm strategjik dhe thelbësor që Gazsjellësi Trans Adriatik do të ketë në hapjen e Korridorit Jugor të Gazit dhe duke iu referuar përcaktimit që programi i Bashkimit Europian mbi rrjetet e energjisë ndëroreuropeane i ka bërë Gazsjellësit Trans Adriatik, si korridori gazsjellës i jugut (itinerari 3 i gazit natyror);

6. *duke pranuar* faktin se secila nga marrëveshjet me qeveritë pritëse e lidhur nga palët mund të ratifikohet nga parlamenti i vendit përkatës në vijim ose njëkohësisht me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje nga parlamenti vendas;

7. *duke pranuar* faktin se Komisioni Europian është informuar në lidhje me negociatat për këtë marrëveshje dhe qëllimet e palëve në lidhje me zbatimin e saj; dhe

8. *me qëllim* krijimin e kushteve dhe standardeve të njëtrajtshme dhe jodiskriminuese për planifikimin, ndërtimin dhe përdorimin e Gazsjellësit Trans Adriatik në përputhje me legjislacionin vendas të palëve dhe me marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe traktatet e zbatueshme për secilën nga palët;

9. *duke pasur* në konsideratë memorandumimin e mirëkuptimit midis Qeverisë së Republikës së Greqisë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për bashkëpunim në lidhje me projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik, të nënshkruar në Nju-Jork, më datë 27 shtator 2012,

bien dakord si më poshtë vijon:

### Neni 1 Përkufizime

Shprehjet me germa të mëdha të përdorura në këtë marrëveshje (përfshirë hyrjen), kanë kuptim që u është dhënë në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.



## Neni 2

### **Mbështetja e projektit dhe bashkëpunimi**

1. Palët do të lehtësojnë, bëjnë të mundur dhe mbështesin zbatimin e projektit, si dhe do të bashkëpunojnë dhe koordinohen me njëra-tjetrën në këtë drejtim dhe do të sigurojnë kushte të qëndrueshme, transparente dhe jodiskriminuese për zbatimin dhe realizimin e projektit.

2. Palët bien dakord që transporti do të kryhet sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe legjislacionit të zbatueshëm, sipas traktateve të Komunitetit dhe Traktatit për Komunitetin e Energjisë, në lidhje me të, si dhe pa shkaktuar vonesa, kufizime ose kosto të paarsyeshme.

## Neni 3

### **Marrëdhënia me ligjet dhe traktatet**

1. Asnjë nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të kërkojë:

a) derogimin e Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë nga ndonjë prej kërkesave themelore të traktateve të Komunitetit; ose

b) derogimin e Republikës së Shqipërisë nga ndonjë prej kërkesave themelore të Traktatit për Komunitetin e Energjisë.

2. Pjesëmarrësit në Projekt do të konsiderohen si “Investitorë” për efekt të nenit 1 (7) të Traktatit për Kartën e Energjisë dhe Projekti, së bashku me çdo aspekt të tij, si dhe çdo interes që investitorët mund të kenë në bazë të ndonjë marrëveshjeje në lidhje me Projektin, do të konsiderohen secili si “investim” në territorin e palës përkatëse për efekt të nenit 1 (6) të Traktatit për Kartën e Energjisë.

## Neni 4

### **Subjektet e autorizuar**

1. Secila nga palët emëron personat e mëposhtëm që të dërgojnë dhe të marrin komunikime dhe njoftime nga palët e tjera në lidhje me këtë marrëveshjeje dhe të veprojnë në cilësinë e koordinatorit për të drejtat dhe detyrimet e palës sipas kësaj marrëveshjeje:

a) për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

b) për Republikën e Greqisë, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet Ekonomike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme; dhe

c) për Republikën e Italisë. Departamenti i Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë e Furnizimit dhe infrastrukturën energjetike pranë Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik.

(secili veçmas “subjekt i autorizuar” dhe së bashku “subjekte të autorizuar”).

2. Secila nga palët mund të caktojë persona të tjerë ose zëvendësues që të veprojnë si subjekte të autorizuar për efekt të kësaj marrëveshjeje, duke i dhënë njoftim në lidhje me këtë palëve të tjera.

## Neni 5

### **Marrëveshjet me qeveritë pritëse**

1. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë, që janë palët në territoret e të cilave do të kalojë pjesa më e madhe e Gazsjellësit Trans Adriatik, nëpërmjet qeverive të tyre përkatëse pritëse, kanë lidhur ose do të lidhin secila nga një marrëveshjeje të qeverisë pritëse me investitorin e projektit në përputhje me kërkesat themelore respektive të cituara në nenin 3 (1) më sipër, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, dispozita në lidhje me tatimet (përfshirë vlerën e tatimit), që i zbatohen investitorit të projektit në juridiksionin e secilës prej këtyre palëve. Secila nga marrëveshjet me qeveritë pritëse do të ratifikohet me ligjin e secilës palë.

2. Secila nga marrëveshjet me qeveritë pritëse që palët do të lidhin:

a) do të konsiderohet e lidhur ose do të lidhet në përputhje dhe në zbatim të kësaj marrëveshjeje; dhe

b) do të jetë ligj nëpërmjet të cilit do të zbatohen detyrimet, marrëveshjet dhe premtimet e secilës palë, sipas ose në lidhje me këtë marrëveshje, dhe asnjë ligj i zakonshëm i secilës palë (përfshirë interpretimin dhe zbatimin e procedurave të sanksionuara prej tij), i cili bie në kundërshtim ose nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes me qeverinë pritëse të lidhur nga pala në fjalë, nuk do të kufizojë, pakësojë ose cenojë të drejtat që i janë dhënë investitorit të projektit ose çdo pjesëmarrësi tjetër në projekt nga dispozitat e asaj marrëveshjeje me qeverinë pritëse apo të ndryshojë, të shfuqizojë ose të ketë përparësi në çfarëdolloj mënyre, qoftë pjesërisht apo tërësisht, mbi marrëveshjen me qeverinë pritëse në fjalë.

#### Neni 6 **Autorizimet**

Secila nga palët njih rëndësinë strategjike kombëtare që projekti ka për atë palë dhe rrjedhimisht do të marrë të gjitha masat për lehtësimin e realizimit të projektit në territorin e saj, përfshirë dhënien e të gjitha autorizimeve të nevojshme për zbatimin e projektit dhe zhvillimin e tij në përputhje me ligjet e palës përkatëse pa vonesa ose kufizime të paarsyeshme.

#### Neni 7 **Mosndërprerja e projektit**

1. Asnjë nga palët e kësaj marrëveshjeje nuk do të ndërpresë, zvogëlojë, vonojë ose pengojë në asnjë mënyrë rrjedhjen (në drejtim të njëjtë dhe/ose të kundërt) të gazit natyror nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik, përveç nëpërmjet një organi kompetent sipas rregullores së EU-së 994 /2010 në lidhje me sigurinë e furnizimit me gaz (rregullorja për furnizimin me gaz).

2. Në rast se verifikohet ndonjë rrethanë ose situatë, e cila lë shkak të arsyeshëm për të besuar se ekziston rreziku i ndërprerjes, pakësimit ose pengimit me çdo lloj mënyre tjetër të ndonjë aspekti të projektit (përveç rrjedhjes së gazit natyror nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik), Pala, në territorin e secilës është shfaqur rreziku, do të bëjë të gjitha përpjekjet e ligjshme dhe të arsyeshme për të eliminuar këtë rrezik.

3. Në rast se verifikohet ndonjë rrethanë ose situatë ndërprerjeje, pakësimi ose pengimi me çdo lloj mënyre tjetër të ndonjë aspekti të projektit, pala në territorin e së cilës është verifikuar kjo situatë ose rrethanë do të njoftojë në mënyrë të menjëhershme palët e tjera dhe investitorin e projektit në lidhje me rrethanën ose situatën, do të japë detaje të hollësishme në lidhje me arsyet e krijimit të rrethanës ose të situatës dhe (përveç rastit të ndërprerjes, të pakësimit ose të pengimit të rrjedhjes së gazit natyror nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik), do të bëjë të gjitha përpjekjet e ligjshme dhe të arsyeshme për të eliminuar rrethanën ose situatën, si dhe do të ndihmojë në kthimin sa më parë të jetë e mundur, të aspektit të cenuar të projektit në gjendjen e mëparshme.

#### Neni 8 **Përputhshmëria e kushteve të projektit**

Palët pranojnë se duke pasur parasysh natyrën ndërkufitare të projektit, është thelbësore që të zbatohen kushte të koordinuara dhe të njëtrajtshme në lidhje me tërësinë e projektit, përfshirë këtu kushtet teknike, shoqërore, ato në lidhje me sigurinë, mjedisin, komunitetin dhe kushtet e punës dhe krijimi ndërmjet palëve i këtyre kushteve të koordinuara dhe të njëtrajtshme do të jetë një nga përgjegjësitë e komisionit zbatues të cituar në nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.



## Neni 9 Tatimet

Për përcaktimin e bazës së vlerësimit tatimor në lidhje me investitorin e projektit, do të gjejnë zbatim dispozitat e legjislacionit kombëtar, bazuar në parimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Për të ardhurat dhe kostot e investitorit të projektit, do të përcaktohen parametra uniformë dhe të përshtatshëm për shpërndarjen, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me përcaktimin e të ardhurave nga veprimtaria tregtare, nëpërmjet marrëveshjeve për transferimin e çmimit të lidhura ndërmjet autoriteteve fiskale të secilës prej palëve, të cilat do të kenë efekt detyrues për to, si dhe me autoritetet fiskale të Konfederatës Zvicerane (e cila përfaqëson juridiksionin ku është themeluar investitori i projektit). Marrëveshjet për transferimin e çmimit do të kenë një kohëzgjatje minimale prej 25 vjetësh dhe nuk do të jenë subjekt ndryshimesh ose zgjidhje pa miratimin e investitorit të projektit. Parametrat e shpërndarjes për të cilat është rënë dakord nga palët dhe që janë përcaktuar në secilën prej marrëveshjeve për transferimin e çmimit, do të pasqyrohen, gjithashtu, edhe në marrëveshjet me qeveritë pritëse që secila nga palët ka lidhur.

## Neni 10 Komisioni i zbatimit

Një komision zbatimi është krijuar dhe përbëhet nga dy përfaqësues, rregullisht të autorizuar nga secila palë (komisioni i zbatimit). Komisioni i zbatimit do të mbikëqyrë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të punojë me investitorin e projektit me qëllim rënien dakord mbi një protokoll që do të nënshkruhet midis palëve, i cili do të krijojë një strukturë kushtesh të koordinuara dhe të njëtrajtshme siç përcaktohet në nenin 8, të cilat do t'i zbatohen projektit në tërësi dhe me miratimin e anëtarëve të tij, do të ndërmarrë çdo veprim tjetër të konsideruar të nevojshëm për të lehtësuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Investitori i projektit do të ketë të drejtë të emërojë një vëzhgues pranë komisionit të zbatimit, i cili mund të marrë pjesë në mbledhjet dhe veprimtaritë e tjera të komisionit të zbatimit. Komisioni i zbatimit do të jetë një organ vetëm këshillimor dhe nuk do të ketë kompetenca për të marrë vendime përfundimtare dhe detyruese për llogari të palëve, përfshirë ato lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj marrëveshjeje.

## Neni 11 Përgjegjësia

Mospërbushja ose refuzimi nga secila palë në këtë marrëveshje për të përmbushur ose për të zbatuar detyrimet e saj, për të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe për të njohur të gjitha të drejtat dhe përfitimet siç parashikohet në këtë marrëveshje, do të përbëjë shkelje të detyrimeve që lindin, sipas kësaj marrëveshjeje për palën në fjalë. Përgjegjësia e secilës palë, sipas këtij neni, në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, do të zbatohet edhe në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e çdo autoriteti shtetëror ose subjekti shtetëror.

## Neni 12 Ndryshimet dhe zgjidhja

Asnjë nga palët nuk do të ndryshojë ose do të bëjë përpjekje që të shmangë në ndonjë mënyrë tjetër ose të kufizojë këtë marrëveshje pa miratimin paraprak me shkrim të secilës prej palëve të tjera. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të miratohet me shkrim nga të gjitha palët dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 14 të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi deri në datën e përfundimit të dekomisionimit të Gazsjellësit Trans Adriatik në tërësi. Asnjëra nga palët nuk mund të denoncojë ose të heqë dorë nga kjo marrëveshje apo të pezullojë përmbushjen e detyrimeve përkatëse, sipas kësaj marrëveshjeje, pa miratimin paraprak të secilës prej palëve të tjera. Megjithatë, në rast se Gazsjellësi Trans Adriatik nuk përzgjidhet nga

Konsorciumi i Shah Denizit për transportimin e gazit natyror nga Rajoni i Detit Kaspik drejt Europës, TAP, në marrëveshje me palët dhe brenda një periudhe prej 24 muajsh nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të identifikojë burime alternative furnizimi. Në rast mospërzgjedhje dhe nëse TAP nuk identifikon burime alternative brenda afatit të mësipërm, secila prej palëve do të ketë të drejtë të heqë dorë nga kjo marrëveshje, duke njoftuar me shkrim palët e tjera tre muaj përpara nëpërmjet rrugëve diplomatike.

#### Neni 13

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

#### Neni 14

### Hyrja ne fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur instrumentet përkatëse të ratifikimit janë shkëmbyer ndërmjet të gjitha palëve (data efektive). Me ratifikimin e saj, secila palë do të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje është hartuar në tre ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze.

Lidhur sot, më 13 shkurt 2013 në Athinë, Greqi.

## SHTOJCË PËRKUFIZIME

“Filial” nënkupton, në lidhje me një subjekt, çdo person tjetër që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollon, kontrollohet ose është nën një kontroll të përbashkët me këtë subjekt. Për qëllimet e këtij përkufizimi, “kontroll” nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kompetencave për të drejtuar ose për të vendosur mbi administrimin dhe politikën e një subjekti, qoftë nëpërmjet zotërimit të shumicës ose të një pjesëmarrje kontrolluese në aksionet me të drejtë vote, në kapital ose nëpërmjet interesave të tjera pasurore në një subjekt, të cilat burojnë nga ligji ose marrëveshja, e cila nje këto kompetenca ose të drejta vote.

“Marrëveshje” nënkupton këtë marrëveshje ndërqeveritare, duke përfshirë çdo shtojcë bashkëlidhur, siç mund të ndryshohet, shtohet ose ndryshohet në çdo mënyrë tjetër herë pas here.

“Autorizim” nënkupton çdo autorizim, pëlqim, koncesion, licencë, leje ose formë tjetër miratimi, nga ose me ndonjërin prej palëve ose organeve shtetërore, i cili i është dhënë ose do t’i jepet ndonjërit prej pjesëmarrësve në projekt në lidhje me ndonjërin nga veprimtaritë që lidhen me projektin.

“Traktatet e Komunitetit” nënkupton traktatin për themelimin e Komunitetit Europian, (Traktatin e Romës, të ndryshuar me Traktatin e Amsterdimit dhe Traktatin e Nicës), Traktatin e Maastrichtit (të ndryshuar me Traktatin e Amsterdimit dhe Traktatin e Nicës) dhe Traktatin për Themelimin e Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, siç janë zëvendësuar ose pasuar tashmë nga Traktati i Lisbonës, që është Traktati për Themelimin e Bashkimit Europian dhe Traktati për funksionimin e Bashkimit Europian.

“Kushtetutë” nënkupton në lidhje me secilën palë, kushtetutën e asaj pale, siç mund të ndryshohet ose zëvendësohet herë pas here.

“Sipërmarrës” nënkupton çdo person, i cili i ofron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë investitorit të projektit ose filialeve të tij, nëpërmjet kontraktimit, nënkontraktimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër, mallra, punime, teknologji ose shërbime, përfshirë ato financiare (përfshirë ndër të tjera kreditimin, financimin, sigurimin ose shërbimet e tjera financiare), të cilat kanë lidhje me projektin dhe kanë një vlerë kontrate vjetore prej të paktën 100,000 eurosh, duke përjashtuar megjithatë, çdo individ, i cili vepron në cilësinë e punëmarrësit të ndonjë personi tjetër.

“Datë efektive” ka kuptimin e dhënë në nenin 14.



“Traktati i Kartës së Energjisë” nënkupton Traktatin e Kartës së Energjisë të hapur për nënshkrim në Lisbonë në datë 17 dhjetor 1994 dhe të hyrë në fuqi nga data 16 prill 1998.

“Traktati i Komunitetit të Energjisë” nënkupton Traktatin e Komunitetit të Energjisë, të hapur për nënshkrim në Athinë në datë 25 tetor 2005 dhe të hyrë në fuqi nga data 1 korrik 2006.

“Subjekt” nënkupton çdo shoqëri, korporatë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, shoqëri komandite, shoqëri kolektive, shoqëri me kapital të përbashkët, shoqëri me kapital të përbashkët të paregjistruar, shoqatë, kartel apo person tjetër juridik, organizatë ose ndërmarrje tjetër të organizuar rregullisht nëpërmjet ndonjë traktati ose sipas ligjit të ndonjë shteti ose nënndarje të tij.

“Shitës gazi natyror” nënkupton çdo person i cili shet gaz natyror në pikën ku Gazsjellësi Trans Adriatik lidhet me rrjetin kombëtar të transmetimit ose shpërndarjes së gazit natyror të një pale.

“Qeveri pritëse” nënkupton qeverinë qendrore ose federale të njëjës prej palëve.

“Marrëveshje me qeveritë pritëse” nënkupton marrëveshjet që janë lidhur ose do të lidhen midis:

a) qeverisë pritëse të Republikës së Greqisë (për llogari të Republikës së Greqisë) dhe Investitorit të projektit; dhe

b) qeverisë pritëse të Republikës së Shqipërisë (për llogari të Republikës së Shqipërisë) dhe investitorit të projektit.

“Akt zbatimi” nënkupton në lidhje me secilën prej palëve, çdo ligj ose autorizim të asaj pale ose të ndonjë organi shtetëror të saj ose çdo marrëveshje me qeverinë pritëse ose marrëveshje për projektin, e cila miraton dhe rendit të drejtat dhe angazhimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

“Siguruesi” nënkupton çdo shoqëri sigurimi ose person tjetër të autorizuar për të ofruar ose që ofron mbulim në sigurime (duke përfshirë mbulimin e risigurimit), për të gjitha ose pjesë të risqeve që lidhen me Gazsjellësin Trans Adriatik dhe/ose projektin, si dhe pasardhësit ose çesionarët e lejuar të kësaj shoqërie sigurimi apo personi.

“Marrëveshje interkonjeksioni” nënkupton marrëveshjen midis një pjesëmarrësi në projekt dhe çdo pale, subjekti shtetëror, organi shtetëror ose Gazsjellësit Trans Anatolian për interkonjeksionin e Gazsjellësit Trans Adriatik ose Gazsjellësit Trans Anatolian me rrjetin kombëtar të shpërndarjes së gazit natyror të secilës prej palëve.

“Ligj” nënkupton ligjet e detyrueshme dhe në fuqi kohë pas kohe për secilën prej palëve, përfshirë kushtetutën e saj, si dhe të gjitha ligjet e tjera, kodet, dekretet, statutet, rregulloret, memorandumet, deklaratat, vendimet themelore, urdhrat, aktet normative dhe politikat, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat kjo palë është anëtare, së bashku me të gjitha aktet e saj të brendshme, ligjet dhe dekretet për ratifikimin ose zbatimin e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe interpretimet gjyqësore që kanë përparësi në lidhje me këto instrumente ligjore.

“Huadhënës” nënkupton çdo institucion financiar (përfshirë bankat tregtare, agjencitë shumëpalëshe të kreditimit zotëruesit e obligacioneve, garantuesit (përveç aksionarëve) dhe agjencitë e eksportit të kreditit) ose çdo person tjetër që ofron borxh, hua, kreditim financiar, zgjerim kredie ose çdo mjet tjetër financimi për investitorin e projektit në lidhje me Gazsjellësin Trans Adriatik (përfshirë rifinancimin e tij), si dhe pasardhësit dhe çesionarët e lejuar të këtij institucioni financiar ose çdo personi tjetër.

“Gaz natyror” nënkupton hidrokarburet që nxirren nga nëntoka në gjendjen e tyre natyrale dhe që janë në gjendje të gaztë në temperaturën dhe trysinë e tyre normale.

“Person” nënkupton çdo person fizik ose subjekt.

“Projekt” nënkupton vlerësimin, zhvillimin, projektimin, ndërtimin, instalimin, financimin, rifinancimin, zotërimin, operimin (përfshirë transportin e gazit natyror nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik), riparimin, zëvendësimin, meremetimin, mirëmbajtjen, zgjerimin, shtimin (përfshirë atë anësor) dhe në momentin përkatës, dekomisionimin e Gazsjellësit Trans Adriatik.

“Marrëveshje për projektin” nënkupton çdo marrëveshje, kontratë, licencë, koncesion, ose dokument tjetër, përveç kësaj marrëveshjeje dhe marrëveshjeve me qeveritë pritëse, në të cilin/ën, nga njëra anë, një palë, organ shtetëror ose subjekt shtetëror dhe nga ana tjetër, pjesëmarrësit në projekt janë ose do të bëhen palë në lidhje me këtë projekt, duke përfshirë marrëveshjet e interkonjeksionit, siç secila prej këtyre marrëveshjeve, kontratave, licencave, koncesioneve ose dokumenteve të tjera mund të zgjerohen, rinovohen, zëvendësohen ose ndryshohen herë pas here në përputhje me kushtet e tyre.

“Investitori i projektit” nënkupton Trans Adriatik Pipeline AG, një shoqëri e organizuar në përputhje me legjislacionin e Konfederatës Zvicerane.

“Pjesëmarrësit në projekt” nënkupton investitorin e projektit, aksionarët, transportuesit, sipërmarrësit, huadhënësit dhe shitësit e gazit.

“Aksionar” nënkupton, në çdo kohë, çdo person i cili zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë investim në kapital ose çdo formë tjetër interesi pasuror tek investitori i projektit, si dhe çdo filial pasardhës dhe çesonar të lejuar të këtij personi.

“Transportues” nënkupton çdo person, i cili ka të drejtë (që buron nga ligji, nga kontrata ose çdo mënyrë tjetër) të transportojë gaz natyror, duke përdorur tërësisht ose pjesërisht Gazsjellësin Trans Adriatik.

“Organ shtetëror” nënkupton, në lidhje me secilën palë, qeverinë qendrore ose federale të palës, si dhe çdo organ apo autoritet qendror, federal, rajonal, bashkiak, vendor, autoritetet e qarqeve ose organet e tjera (por për të shmangur çdo dyshim, do të përjashtohen organet e pavarura) të kësaj pale, si dhe çdo pjesë tjetër përbërëse të organeve të mësipërme.

“Subjekt shtetëror” nënkupton çdo subjekt, në të cilin një palë zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kontrollin e kapitalit, interesa pasurorë ose interesa ekonomike të ngjashme ose që zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga pala. Për efekt të këtij përkufizimi, “kontroll” nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kompetencave për të drejtuar ose për të vendosur mbi drejtimin dhe politikat e një subjekti, qoftë nëpërmjet zotërimit të shumicës ose interesave të tjera kontrolluese të aksioneve me të drejtë vote, kapitalit ose nëpërmjet interesave të tjera pasurore në një subjekt, në përputhje me ligjin ose me marrëveshje midis personave, të cilët japin këto kompetenca ose të drejta vote.

“Tatime” nënkupton të gjitha detyrimet ekzistuese dhe të ardhshme, detyrimet doganore, pagesat, tarifrat, gjobat, vlerësimet, taksat (përfshirë TVSH-në ose taksat nga shitja), kontributet e pagueshme kundrejt ose të vendosura nga shteti, ose nga ndonjë organ apo departament shtetëror, qoftë ky qendror ose vendor, ose nga çdo organ tjetër kompetent për vendosjen e këtyre detyrimeve brenda territorit të një shteti dhe “tatim” nënkupton secilin nga detyrimet e listuara më sipër dhe tatimet dhe taksat do të interpretohen rrjedhimisht në varësi të sa më sipër.

“Gazsjellësi Trans Adriatik” nënkupton sistemin e tubacionit të gazit natyror, i cili do të shtrihet nga Republika e Greqisë në afërsi të kufirit turko-grek, të kalojë nëpër Republikën e Shqipërisë, deri në afërsi të Leçes në Republikën e Italisë, duke përfshirë të gjitha asetet fizike të lidhura me të, si dhe impiantet, pajisjet, makineritë, tubacionet, cisternat, stacionet e kompresorëve, kabllot e fibrave optike dhe asetet e tjera ndihmëse.

“Transport” nënkupton transportimin, ngarkesën ose çdo formë tjetër transporti të gazit natyror, nëpërmjet çdo mënyre të ligjshme.



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 4.4.2013  
Doli nga shtypi më 4.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 48 lekë